

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5890
E shtunë, 28 shtator 2019
çmimi 0.40 €

OShP-ja bllokoi prodhimin e vulave për zgjedhje, KQZ-ja ankohet | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI | FAQE 4-5

PARTITË POLITIKE TA RIKONFIRMOJNË QËNDRIMIN PËR KUFIJTË



- DIALOGU ME SERBINË PARIM KRYESOR TA KETË NJOHJEN RECIPROKE MES DY SHTETEVE NË KUFIJTË E TASHËM TË KOSOVËS

Ish-ministria për Dialog, njëherësh kryetare e Alternativës Demokratike të Kosovës (ADK), Edita Tahiri, ka thënë se subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore duhet ta rikonfirmojnë edhe një herë qëndrimin e tyre kundër ndryshimit të kufijve Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", Tahiri ka theksuar se procesi i dialogut duhet t'i ketë vijat e kuqe siç kanë qenë prej vitit 2011 kur ajo e ka drejtuar këtë proces. Ajo ka thënë se kjo periudhë e zgjedhjeve ka treguar se Kosova ka avancuar në kuptimin e konsolidimit të skenës politike pasi, sipas saj, gari-

mi i disa subjekteve politike në mënyrë individuale tregojnë për një proces të avancuar të demokracisë. Tahiri ka thënë se nuk i hyri garës për deputete pasi zgjedhjet nuk ishin të rregullta, por të parakohshme dhe se kishte para vetes disa projekte ndërkombëtare


OPINION

FUSHATA NUK NDRYSHON ASGJË, KLIENTELIZMI DHE BISEDIMET ME SERBINË JANË PËRCAKTUESE F. 10

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



AMBASADA AMERIKANE BËN THIRRJE TË RAPORTOHEN PARREGULLSITË NË ZGJEDHJET E 6 TETORIT F. 3

AAK-JA PRISH KOALICIONIN ME PDK-NË NË GJAKOVË F. 8

MIRATOHET BUXHETI I PRISHTINËS PËR VITIN 2020 F. 8

EKONOMI

FILLON EKZEKUTIMI I SUBVENCIONEVE NË VLERË RRETH 11.9 MILIONË EURO F. 9

LIMAJ DHE SHALA PËRURONJË ASFALTIMIN E ZONËS EKONOMIKE NË SUHAREKË F. 9

KULTURË

REXHEP HOXHA, KLASIKU I FUNDIT I LETËRSISË SHOQPE PËR FËMIJË E TË RINJ F. 13

Prof. Dr. Xhahid BUSHAT

FUSHATA PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT



Osmani: Qytetarët e Kosovës meritojnë qeverisje me duar të pastra



Haradinaj: Pa Deçanin nuk mund t'i fitojmë zgjedhjet



Limaj: Projekti 'Bashkë për shtetin' po përkrahët fuqishëm anembanë vendit



Pacolli: Ne s'bëjmë me gisht kah problemet, ne ofrojmë zgjidhje për to



Kurti në Rahovec premtan mbështetje të madhe për prodhuesit vendorë



Veseli: Pensionistëve ua rrisim pensionet 80 për qind

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bundestagu konfirmon qëndrimin ndaj Shqipërisë për bisedimet me BE-në

Bundestagu gjerman konfirmoi qëndrimin pro hapjes së bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë duke renditur një sërë parakushtesh, ato që duhet të plotësohen para Konferencës ndërqeveritare dhe të tjerat që do të duhet të plotësohen para hapjes së bisedimeve për kapituj konkretë

BERLIN, 27 SHTATOR - Bundestagu gjerman konfirmoi të enjten në mbrëmje, pa ndonjë ndryshim, qëndrimin e grupit të tij kryesor parlamentar, CDU/CSU si dhe të socialdemokratëve të SPD-së, pro hapjes së bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë duke renditur një sërë parakushtesh të ndara në dy grupe: në ato që duhet të plotësohen para Konferencës ndërqeveritare, e cila shënon formalisht hapjen e procesit dhe të tjerat që do të duhet të plotësohen para hapjes së bisedimeve për

kapituj konkretë, që në rastin e Shqipërisë pritet të jenë kapitulli 23-24 që lidhen me shtetin e së drejtës (reforma e sistemit gjyqësor dhe të drejtat themelore) dhe liritë themelore, sigurinë dhe drejtësinë, ka njoftuar vova. Sipas kushteve të Parlamentit gjerman, konferenca e pare ndërqeveritare duhet të zhvillohet atëherë kur Qeveria Federale të konstatojë plotësimin nga ana e Shqipërisë të dy çështjeve: Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe të Gjykatës së

Lartë si dhe të merret vendim për reformën zgjedhore". Sa i takon kësaj reforme, deputetët gjermanë saktësojnë se ajo duhet të jetë "në përputhje të plotë me rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe të sigurojë një financim transparent të partive dhe fushatave zgjedhore si dhe të bazohet në rezultatet e Komisionit ad hoc të reformës zgjedhore. Rishikimi i draftit të përgatitur atje, duhet të bëhet në një dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës të të gjitha forcave politike, siç rekomandohet edhe në raportin e ODIHR të datës 5 shtator 2019". Nisja e bisedimeve për kapituj konkretë, kushtëzohet me një numër më të madh çështjes, të paktën 7 të tilla: Zbatimi i ligjit për reformën zgjedhore të iniciuar; Fillimi i procedimeve penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk u kuali-

fikuan në procesin e vettingut për shkak të sjelljes së dënueshme; Fillimi i ndjekjes penale dhe eventualisht i proceseve gjyqësore kundër atyre që janë të përfshirë në blerjen e votave në zgjedhje, dhe ndjekjen serioze dhe të shpejtë të procedimeve; Angazhimi i strukturës speciale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe aftësia e saj për të punuar; Progres solid në krijimin e bilanci suksesi në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në të gjitha nivelet, përfshirë iniciimin dhe procedimet e para të përfunduara kundër nëpunësve civilë dhe politikanëve të nivelit të lartë. Këto përfshijnë hetime proaktive, eventualisht ndjekje penale dhe dënime në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar; Progres i prekshëm në reformën administrative, përfshirë rishikimin e qëndrimeve

të zyrtarëve të lartë dhe drejtorëve, edhe nën këndvështrimin e parregullsisve dhe një vendim përfundimtar për ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019 nga Gjykata Kushtetuese. Nëse urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve, ato duhet të zhvillohen në bazë të ligjit të ri zgjedhor", saktësohet në dokumentin e miratuar nga deputetët gjermanë. Në ndryshim nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut mori një "Po" të pastër dhe rruga e saj drejt një vendimi pozitiv nga Këshilli Evropian javët e ardhshme, është tanimë po ashtu shumë më e sigurt. Mbetet për t'u parë nëse vendet e anëtare do të caktojnë ose jo një datë fikse, për bisedimet, duke qenë se Gjermania e lidh me realizimin e kushteve të caktuara që kërkojnë kohën e tyre për t'u përmbushur. Në një postim në Twitter, komisionari për Zgjerimin Johannes Hahn theksoi se është "shumë i mirëpritur votimi i sotëm në Bundestagun gjerman në favor të hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në tetor. Njohja e progresit konkret është thelbësor, si nxitje për reformat në Ballkanin Perëndimor dhe për besueshmërinë e BE". Ndërsa nga ana e tij presidenti Ilir Meta bëri thirrje që "tani urgjent të punohet për zgjidhjen e shpejtë të krizës së rëndë politike dhe plotësimin e 9 kriterëve të qarta! Po të ishin dëgjuar këshillat e tyre në kohë, sot do të kishim marrë një vendim pa kushte ashtu si Maqedonia e Veriut. Reflektim serioz për t'i dhënë Shqipërisë një mundësi reale, jo imagjinare!", tha Meta duke e mbyllur postimin e tij në Facebook me një urim për Maqedoninë e Veriut.



Sekretari Pompeo viziton Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut

UASHINGTON, 27 SHTATOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Michael R. Pompeo do të vizitojë javën e ardhshme Italinë, Vatikanin, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë.

Në turneun që do të zgjasë nga 1 deri në 6 tetor, Pompeo do të marrë pjesë në një simpozium në Vatikan dhe do të takohet me Papa Françeskun.

Në Romë, sekretari i Shtetit do të takohet me presidentin Sergio Mattarella, kryeministrin Giuseppe Conte dhe ministrin e Jashtëm Luigi Di Maio. Më pas sekretari i Shtetit do të shkojë në

Mal të Zi, ku do të takohet me presidentin Milo Gjukanović, kryeministrin Dushko Marković dhe ministrin e Jashtëm Srgjan Darmanović.

Gjatë turneut, Pompeo do të shkojë edhe në Maqedoninë Veriore, ku do të takohet me presidentin Stevo Pendarovski, kryeministrin Zoran Zaev dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë.

Një zyrtar i lartë i Departamentit të Shtetit tha se këto vizita do t'ia vinin theksin tek angazhimi i ShBA-së në NATO dhe te dëshira e Uashingtonit për zgjerim. Ai tha se do të ishte një sinjal mbështetës për Malin e Zi si

vend i ri anëtar dhe për Maqedoninë e Veriut, rruga e së cilës është hapur tashmë për anëtarësim.

I pyetur nga "Zëri i Amerikës", se pse Sekretari i Shtetit nuk po shkon në Shqipëri, zyrtari tha se arsyeja është thjesht se Pompeo po shkon për te vendet e sapoanëtarësuar në NATO. Megjithatë vizita nuk ka për synim bisedimet e Kosovës dhe Serbisë, zyrtari tha se emërimi i zëvendës ndihmës sekretarit të Shtetit Matthew Palmer si i dërguar i posaçëm për Ballkanin, tregon angazhimin e ShBA-së për zgjidhjen e problemeve në



rajon. "Ai do të jetë në gjendje të theksojë mbështetjen tonë për një zgjidhje të çështjeve, përfshirë ato mes Serbisë dhe Kosovës", tha ai për vizitën. Pompeo do të mbarojë turneun

me një vizitë në Greqi, ku do të takohet me kryeministrin Kyriakos Mitsotakis, ministrin e Jashtëm Nikolaos Dendias, dhe ministrin e Mbrojtjes Nikolaos Panagiotopoulos.

Është mbajtur mbledhja e radhës e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

OShP-ja bllokoi prodhimin e vulave për zgjedhje, KQZ-ja ankohet

Ndonëse zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbahen edhe një javë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është duke u ballafaquar me problemin e prodhimit të vulave, pasi që Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) ka bllokuar procesin e tenderit për prodhimin e vulave, duke lëshuar një masë të përkohshme për pezullimin e aktivitetit. Vendimi i OShP-së ka ardhur pas ankesës së një operatori. Me këtë rast, anëtarët e KQZ-së u kanë bërë thirrje institucioneve përkatëse që në mënyrë urgjente t'i trajtojnë këto çështje në mënyrë që të mos krijohen vështirësi për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Enis Halimi, në mbledhjen e së premtes ka bërë me dije se ky institucion është duke u ballafaquar me dy probleme të cilat do ta vështirësojnë procesin zgjedhor të 6 tetorit. Ai ka treguar se Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) ka bllokuar procesin e tenderit

për prodhimin e vulave, duke lëshuar një masë të përkohshme për pezullimin e aktivitetit. Por, sipas Halimit, ky problem duhet të zgjidhet sa më parë pasi që nuk ka kohë të pritët shqyrtimi i ankesave nga ofertuesit e tjerë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk mund të procedohet më tutje meqë për prodhimin e tre mijë vulave duhet kohë. "Për furnizimin me vula, që është material i rëndësishëm në zgjedhje, ne kemi zhvilluar një procedurë për tenderim dhe ka pasur

një ankesë në OShP nga një operator. OShP-ja ka lëshuar një masë të përkohshme për pezullimin e aktivitetit në këto kushte. Ne u kemi shkruar atyre letër dhe kemi kërkuar takim për t'u shpjeguar për rëndësinë e vulës. Në procesin zgjedhor kanë aplikuar tre operatorë ekonomikë pasi që janë plotësuar të gjitha kriteret sipas dosjes tenderuese. Kemi shkruar me çmimin më të ulët, që është 14 mijë euro, sepse mendojmë se është e drejtë, për arsye se

çmimi i lirë është edhe kriter ligjor. Ata kanë nxjerrë masë të përkohshme dhe nuk mund të procedojmë tutje, sepse për prodhimin e 3 000 vulave duhet kohë", ka deklaruar Halimi para anëtarëve të KQZ-së.

Po ashtu, ai i ka njoftuar anëtarët e KQZ-së edhe për një problem tjetër me të cilin janë duke u marrë e që ka të bëjë me sistemin online të quajtur K-Vote. Ai e ka quajtur të pafytyrë qasjen dhe sjelljen e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit sepse, sipas Halimit, ajo është duke refuzuar të bashkëpunojë me KQZ-në dhe kjo do t'ia vështirësojë punën për publikimin e rezultateve preliminare nga ana e KQZ-së. "Një problem tjetër ka të bëjë me rezultatet preliminare. Nevojiten të aktivizohen resurset që shteti ka në dispozicion. Kemi hasur në një sjellje të pafytyrë të udhëheqësve të kësaj agjencie të cilët nuk pranojnë takime. Edhe në takimet që i kemi pasur më herët kanë

shkaktuar shumë telashe", ka thënë Halimi.

Ndërsa anëtarët e KQZ-së u kanë bërë thirrje institucioneve përkatëse që në mënyrë urgjente t'i trajtojnë këto çështje që të mos krijohen vështirësi për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Anëtarët e KQZ-së nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sami Hamiti, ka apeluar që këto probleme të shqyrtohen sa më shpejt pasi që nuk ka kohë. "Bëj apel nga KQZ-ja të shqyrtohen shpejt, sepse jemi në një situatë të keqe", ka deklaruar ai. Sipas Hamitit, në këtë situatë është dashur të shkohet me procedurën e negociimit e jo menjëherë me ofertë.

Kurse anëtarët e KQZ-së nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Adnan Rrustemi, ka thënë se ofertuesi nuk i intereson askujt, por se vulat janë të domosdoshme dhe shumë të ndjeshme. "Mua nuk më intereson kush përzgjedhet, por shtypja e vulave që është material i rëndësishëm dhe vula ka rol të madh, prandaj për mua kjo çështje është shumë problematike", ka theksuar Rrustemi, duke shtuar se është skandaloz që agjencitë e kapura politike nuk e kryejnë punën si duhet. "Rasti i dytë është edhe më skandaloz sepse institucionet e agjencitë e kapura politikisht tashmë po e kthejnë borxhin politikisht. Edhe 10 ditë janë zgjedhjet e ne merremi me pengesa formale për mbylljen e komunikimit për detyrat që i kanë", është shprehur Rrustemi. Edhe anëtarët tjetër të KQZ-së nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ilir Gashi, ka thënë se këto çështje duhet të trajtohen me urgjencë nga institucionet përkatëse. "Bëj ftesë publike sepse zgjedhjet janë organizimi më i madh që bëhet në vend, prandaj duhet të ndihet përgjegjës secili institucion, qoftë publik a privat, që është në interes të mbarëvajtjes së këtij procesi. Edhe OShP-ja duhet t'i trajtojë me urgjencë të gjitha veprimet që i bën KQZ-ja", ka deklaruar Gashi.



Ambasada Amerikane bën thirrje të raportohen parregullsitë në zgjedhjet e 6 tetorit

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë u ka bërë thirrje qytetarëve që të raportojnë tek autoritetet kompetente nëse shohin ndonjë akt kërcënimi, blerje votash ose shkelje tjetër në zgjedhjet e parakohshme të

6 tetorit. Sipas kësaj ambasade, zgjedhjet e lira dhe të ndershme varen nga individët dhe organizatat. "Zgjedhjet e lira dhe të drejta varen nga individët si dhe nga organizatat. Monitorimi i zgjedhjeve ndihmon për të siguruar që ato janë të lira. Nëse ju si qytetarë shihni

një akt kërcënimi, blerje votash ose shkelje tjetër, mund ta raportoni atë tek autoritetet", është thënë në mesazhin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë të publikuar të premten në faqen zyrtare në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Partitë politike ta rikonfirmojnë qëndrimin për kufijtë

- Dialogu me Serbinë parim kryesor ta ketë njohjen reciproke mes dy shteteve në kufijtë e tashëm të Kosovës

Ish-ministrja për Dialog, njëherësh kryetare e Alternativës Demokratike të Kosovës (ADK), Edita Tahiri, ka thënë se subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore duhet ta rikonfirmojnë edhe një herë qëndrimin e tyre kundër ndryshimit të kufijve Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka theksuar se procesi i dialogut duhet t'i ketë vijat e kuqe siç kanë qenë prej vitit 2011 kur ajo e ka drejtuar këtë proces. Ajo ka thënë se kjo periudhë e zgjedhjeve ka treguar se Kosova ka avancuar në kuptimin e konsolidimit të skenës politike pasi, sipas saj, garimi i disa subjekteve politike në mënyrë individuale tregojnë për një proces të avancuar të demokracisë. Tahiri ka thënë se nuk i hyri garës për deputete pasi zgjedhjet nuk ishin të rregullta, por të parakohshme dhe se kishte para vetes disa projekte ndërkombëtare



nuk kishte arritur të kalojë një rezolutë të qartë për këtë çështje. Mendoj se në këtë kohë qytetarët duhet t'i shikojnë programet e partive politike dhe të votojnë për programet e jo për liderët e tyre. Pra, në këtë mënyrë do të shprehej një kulturë më e lartë politike, në atë se si votojnë qytetarët dhe kush e merr besimin.

"Epoka e re": Është pritur që edhe ju të bëni koalicion me ndonjë subjekt politik dhe të jeni pjesë e listave zgjedhore për deputete. Pse nuk ndodhi kjo?

Tahiri: Do të isha pjesë e listave sikur këto të ishin zgjedhje të rregullta nacionale. Meqenëse këto janë zgjedhje të parakohshme nuk arrita, sepse unë pas përfundimit të punës në qeveri në vitin 2017, kam marrë angazhime ndërkombëtare të cilat janë me kontrata dhe është e pamundshme t'i ndërpres në këtë periudhë. Jam e angazhuar nga OKB-ja për proceset e paqëndrimit dhe të negociatave. Kush i njeh organizatat ndërkombëtare e di se këto obligime nuk është lehtë të ndërpriten.

"Epoka e re": Dihet që disa subjekte politike janë pretendente për t'i fituar zgjedhjet. Si e parashikoni ju 6 tetorin? Kush do të mund t'i fitojë këto zgjedhje?

Tahiri: Mendoj se kjo periudhë e zgjedhjeve ka treguar se Kosova ka avancuar në kuptimin e konsolidimit të skenës politike, sepse garimi i disa subjekteve politike në mënyrë individuale tregojnë një proces të avancuar të demokracisë. Shoqëritë që janë në tranzicion zakonisht janë të mbushura me parti politike. Ky është një rast që mund të shërbejë për profilizim të partive politike dhe të skenës politike në përgjithësi të Kosovës. Sa i takon saj se kush do të mund ta marrë besimin më të madh të qytetarëve, unë thërras qytetarët që të votojnë për programet e partive

politike dhe jo për liderët. Mendoj se ka ardhur koha që qytetarët t'i shikojnë programet, sepse vetëm në këtë mënyrë vendi mund të reformohet dhe shërbimet qeveritare të jenë në funksion të qytetarëve dhe jo në funksion të politikanëve.

"Epoka e re": Pjesë e fushatës së partive është edhe çështja e dialogut me Serbinë. Cila duhet të jetë qasja e partive politike në këtë fazë për këtë çështje?

Tahiri: Çështja që më së shumti i ka hutuar qytetarët e Kosovës, edhe mua si politikane, ka qenë ideja për ndryshimin eventual të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë në dem të Kosovës. Kjo do të ishte një ndarje e Kosovës dhe veriu me gjithë atë pasuri nëntokësore, duke përfshirë Trepçën dhe Ujmanin, nuk do të ishin nën kontrollin e shtetit të Kosovës. Fundja, në këta 100 vjet ne jemi shtypur e dëbuar vetëm pse Kosova ka qenë tokë e pasur, sidomos pjesa veriore e vendit. Tani mendoj se çështja e parë për dialog është qartësia e partive politike për mbrojtjen e kufijve dhe integritetit territorial. Në periudhën e kaluar të gjitha partitë e kanë bërë, sepse e dimë që presidenti Thaçi mbeti i vetëm në këtë ide. Mirëpo mendoj se ka nevojë që të rikonfirmohet qëndrimi i partive politike rreth çështjes së kufijve dhe se në dialog me Serbinë parim kryesor do të jetë njohja reciproke mes dy shteteve në kufijtë e tashëm të Kosovës. Po ashtu, procesi i dialogut duhet t'i ketë vijat e kuqe siç kanë qenë prej vitit 2011, kur e kam udhëhequr unë këtë dialog. Së pari ato vija të kuqe kanë të bëjnë që në këtë proces të mos flitet për statusin e Kosovës, sepse Kosova është shtet i pavarur dhe sovran me kufij të njohur dhe të vërtetuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Së dyti, ky proces të mos lidhet me rregullimin e brendshëm të Kosovës. Dhe, së

treti, për minoritetin serb vija e kuqe është plani i Ahtisarit. Këto kanë qenë tri vija të kuqe të mëdha që nga fillimi i këtij dialogu dhe kështu duhet të vazhdojë. Po ashtu, në këtë dialog duhet të kërkohet kompensimi i dëmeve të luftës në bazë të së drejtës ndërkombëtare.

"Epoka e re": A do të duhej të zotoheshin liderët e subjekteve politike gjatë kësaj kohe se do të jenë konstruktivë në këtë proces, në mënyrë që më pas mos të kemi përplasje të mëdha për këtë proces?

Tahiri: Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Kushtetuta e Kosovës e thotë qartë se në politikën e jashtme duhet të mbrohen interesat nacionale në çdo vendim në marrëdhëniet ndërkombëtare, përfshirë edhe dialogun e Brukselit i cili duhet të bëhet në pajtim me Kushtetutën e Republikës. Këto janë dy shtylla themelore të politikës së jashtme. Dialogu i Brukselit është një aktivitet ndërkombëtar, ku duhet të respektohen interesat nacionale dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kurse për formimin e delegacionit shtetëror do të mund të flitet pas zgjedhjeve.

"Epoka e re": Meqenëse dialogu me Serbinë pritet të jetë ndër prioritetet kryesore të qeverisë së re, çfarë qeverie do të ishte më e mirë për këtë proces, qeveri e pakicës apo e shumicës?

Tahiri: Pas luftës ne kemi mbajtur disa palë zgjedhje dhe i kemi provuar të gjitha variantet e qeverisë, edhe qeveri të shumicës, po ashtu edhe qeveri të shumicës. Megjithatë, ne nuk kemi treguar që u përmbahemi formateve që mbrojnë interesat nacionale. Unë uroj se qeveria e re të shpreh një përbërje e cila është në gjendje t'i mbrojë interesat nacionale, kufijtë e Kosovës dhe Kushtetutën e Kosovës.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Njohësja e proceseve politike në vend dhe kryetarja e Alternativës Demokratike të Kosovës, Edita Tahiri, ka ftuar qytetarët e Kosovës që më 6 tetor t'i shikojnë programet e partive politike. Ajo ka deklaruar se në ditën e zgjedhjeve qytetarët nuk duhet t'i shikojnë liderët, por platformat e partive në të cilat shihet vizioni i partive për problemet e shoqërisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se në këtë mënyrë do të shprehej një kulturë e lartë politike. "Mendoj se në këtë kohë qytetarët duhet t'i shikojnë programet e partive politike dhe të votojnë për programet e jo për liderët e tyre. Pra, në këtë mënyrë do të shprehej një kulturë më e lartë politike, në atë se si votojnë qytetarët dhe kush e merr besimin", ka thënë Haradinaj. Ai ka bërë me dije se në këtë mënyrë shërbimet qeveritare do të jenë në funksion të qytetarëve dhe jo në funksion të politikanëve.

Tahiri ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme po tregojnë për një pjekuri politike. "Mendoj se kjo periudhë e zgjedhjeve ka treguar se Kosova ka avancuar në kuptimin e konsolidimit të skenës politike, pse garimi i disa subjekteve politike në mënyrë individuale tregojnë një proces të avancuar të demokracisë. Shoqëritë që janë në tranzicion zakonisht janë të mbushura me parti politike. Ky është një rast që mund të shërbejë për profilizim të partive politike dhe të skenës politike në

përgjithësi të Kosovës", ka thënë Tahiri.

Në këtë intervistë Tahiri ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë. Ajo ka thënë se subjektet politike gjatë fushatës duhet ta rikonfirmojnë edhe një herë qëndrimin kundër ndryshimit të kufijve Kosovë - Serbi. "Mendoj se ka nevojë të rikonfirmohet qëndrimi i partive politike rreth çështjes së kufijve dhe se në dialog me Serbinë parim kryesor të jetë njohja reciproke mes dy shteteve në kufijtë e tashëm të Kosovës. Po ashtu, procesi i dialogut duhet t'i ketë vijat e kuqe siç kanë qenë prej vitit 2011, kur e kam udhëhequr unë këtë dialog", është shprehur ajo.

"Epoka e re": Znj. Tahiri, që disa ditë ka filluar fushata zgjedhore. Si e keni parë aktivitetin zgjedhor të subjekteve politike gjatë këtyre ditëve?

Tahiri: Besoj se tani është koha kur duhet të shpalosen programet e partive politike sepse partitë politike në zgjedhje duhet të garojnë me programe të cilat pretendojnë se do të sjellin një mirëqenie më të mirë, zhvillim ekonomik, luftë kundër korrupsionit, si dhe një proces më të shpejtë të reformave drejt integritetit evropian dhe euroatlantike. E fundit dhe më e rëndësishmja është që në këto platforma duhet të parashihet mbrojtja e kufijve të Kosovës, sepse më herët kishin disa ide të rrezikshme në dem të Kosovës dhe kufijve të saj. Kështu që, tani këto parti duhet ta bëjnë të qartë qëndrimin e tyre për këtë çështje, sepse ishim dëshmitarë që Kuvendi i Kosovës

Veseli: Pensionistëve ua rrisim pensionet 80 për qind



PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër, Kadri Veseli, në ditën e tretë të fushatës zgjedhore ka takuar përfaqësuesit e pensionistëve të Kosovës të cilëve iu ka treguar se do t'ua rrisë pensionet për 80 për qind. Si kryeministër, Veseli ka premtuar se do t'i mbulojë tërësisht edhe kostot e barnave specifike për të gjithë të sëmurit kronikë që janë mbi moshën 65-vjeçare dhe do ta njohë e promovoj profesionin e "kujdestarit për të moshuar" në mandatin e tij qeverisës. "Është përgjegjësi morale që të tregojmë mirënjohje

hje ndaj të moshuarve për kontributin e dhënë dhe të kujdesemi që ata të kenë pleqëri sa më të rehatshme. Ne e kemi inkurajuar gjithmonë solidaritetin mes gjeneratave dhe shtetit do t'i japim rol shumë më aktiv për t'u kujdesur për të gjithë të moshuarit. Para përfaqësuesve të pensionistëve, si kryeministër i ardhshëm u zotova se do t'i rrisë pensionet e tyre deri në 80 për qind. Po ashtu, të gjithë pensionistët kontributdhënës me përvojë pune nën 15-vjeçare, që aktualisht janë në skemën e pensioneve themelore, do të kalojnë në kategorinë e pensionistëve kon-

tributdhënës. Ata do të marrin pensione me rritje, sipas përqindjes së përshkallëzuar, bazuar në kohëzgjatjen e viteve të punës dhe në kriteret e strukturës kualifikuese. Për ta rritur kujdesin ndaj të moshuarve, unë do ta njoh dhe do ta promovoj edhe profesionin e 'kujdestarit për të moshuar' dhe qeveria ime do t'i mbulojë tërësisht edhe kostot e barnave specifike për të gjithë të sëmurit kronikë, që janë mbi moshën 65-vjeçare. Të gjithë pensionistët i siguroj se nipat dhe mbesat e tyre më nuk do të largohen, por do të qëndrojnë në Kosovë", ka shtuar Veseli.

Veseli: Kaçanikasit kanë vendosur se kë e duan për kryeministër

Partia Demokratike e Kosovës fushatën zgjedhore e ka vazhduar në Komunën e Ferizajt, Shtërpcë, Hanit të Elezit dhe Kaçanik. Në këtë qytet të fundit Veseli ka thënë se në çdo tubim të PDK-së po ka shumë energji pozitive dhe shumë entuziazëm. "Kaçanikasit kanë vendosur se kë e duan për kryeministër. Ata e dinë se ne jemi të vetmit që do t'i promovojmë të rinjtë dhe do t'u japim mundësi të vërteta për sukses atyre. Ata e dinë sa e rëndësishme është për Kosovën që kryeministër të jetë dikush që di ta forcojë partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

dhe që e ka përvojën e nevojshme për ta bërë këtë", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se zgjedhja është më e qartë se kurdoherë këto ditë: një qeveri në krye me PDK-në që e forcon bashkëpunimin me ShBA-në për ta luftuar korrupsionin dhe për të ndërtuar një ekonomi të fortë ose një koalicion të dobët të izolimit dhe korrupsionit, që nuk ia sjellë asnjë të mirë Kosovës. "Votoni Partinë Demokratike të Kosovës dhe numrin 112. Votoni për një të ardhme më të mirë për qytetarët, për Kosovën", është shprehur Veseli.



Haradinaj: Pa Deçanin nuk mund t'i fitojmë zgjedhjet

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Kandidati për kryeministër i koalicionit parazgjedhor AAK-PSD, Ramush Haradinaj, të premtën ka vazhduar fushatën në Deçan. Para simpatizantëve të mbledhur në sheshin e qytetit ai ka thënë se në këtë garë ka hyrë për të fituar por, sipas tij, pa Deçanin nuk ka fitore më 6 tetor. "Unë kam hyrë për të fituar, por unë nuk mund të fitoj pa Deçanin. Deçani më 6 tetor nuk është mirë të rrijë në shtëpi sepse më 6 tetor na duhet vota juaj. Kush s'ma qetë votën nuk është me mua dhe Kosovën. Ai që e ka ndarë mendjen të më votojë, nuk duhet të rrijë në shtëpi. Mare ju qoftë nëse rrini sepse vota nuk lihet në shtëpi", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se më 6 tetor krejt Deçani dhe Dukagjini duhet të dalin të votojnë. "Numri i koalicionit AAK - PSD është 119. Ky numër e ka bërë ushtrinë, e ka mbrojtur 'Trepçën', e ka mbrojtur territorin e vendit si dhe e ka bërë kryeqytetin me ligj. Shyqyr që erdhi dita me dalë në dritë edhe Deçani, edhe Prishtina. Asnjë projekt Deçanit nuk i është kthyer mbrapa dhe projektet që do t'i sjel-

lë do t'i çojmë përpara", ka thënë ai.

Haradinaj ka folur edhe për ndërtimin e autostradës së Dukagjinit, duke thënë se autostrada nuk do të bëhet për vota, por për zhvillim ekonomik. "Dikush po thotë se nuk na duhet autostrada e Dukagjinit, por si mund ta zhvillojmë vendin pa infrastrukturë? Autostrada e Dukagjinit nuk bëhet për vota, sepse votat e Deçanit e të Dukagjinit i kam marrë para autostradës", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se në qeverisjen e tij të ardhshme paga minimale nuk do të jetë nën 250 euro sepse, sipas tij, koha është për zhvillim ekonomik, për shtesa të fëmijëve dhe për shëndetësi më të mirë.

Para bashkëvendësve Haradinaj ka folur edhe për luftën për liri dhe për veteranët e UÇK-së. Ai ka kritikuar ata që po i quajnë luftëtarët e UÇK-së veteranë të "rrejtshëm". "Ma kanë lodhur shpirtin për fryrje të numrave. Nuk kam fryrë numra, por i kemi dalë zot vendit tonë. Nëse është e nevojshme, sërish i mbathim



çizmet. Nëse nuk e kemi rrejt vendin tonë, nuk do ta rrejmë kurrë as Amerikën", ka deklaruar Haradinaj. Kandidati për kryeministër nga koalicioni AAK - PSD, Ramush Haradinaj, ka mbajtur një tubim elektoral edhe me qytetarët e Junikut. Ai ka thënë se junikasit

janë bashkuar me konceptin 100 për qind shtet. "Juniku i qëndresës historike dje, i bashkuar sot me konceptin 100 për qind Kosovë, prapë po e shkruan historinë, duke iu përgjigjur mbështetjes masive të referendumit për shtetin e fortë e të sigurt, ekonomikisht të rimëkëmbur.

Koalicioni AAK-PSD, i përbërë nga njerëzit e sprovuar që kanë ditur të udhëheqin me logjikë sovraane, do të dijë ta zhvillojë sektorin privat, ta subvencionojë bujqësinë dhe prodhimin vendor për të krijuar vlerë të shtuar për ekonominë e vendit", ka deklaruar Haradinaj.

Osmani: Qytetarët e Kosovës meritojnë qeverisje me duar të pastra

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Vullneti i qytetarëve të Kosovës për LDK-në nuk mund të blihet nga përfaqësuesit e "Klanit Pronto". Kështu ka deklaruar të premtën në Therandë kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës për kryeministër, Vjosa Osmani. "Qytetarët e Kosovës meritojnë një qeverisje me duar të pastra. Përbuzni mashtrimet e 'Klanit Pronto' dhe të atyre që bashkëpunojnë me ta, të cilët po provojnë që ta blejnë me para të krimin dhe të korrupsionit besimin tuaj. Përbuzni të tillët, mbyl-

luani derën, sepse ato para janë të vjedhura nga djersa e popullit", është shprehur ajo gjatë tubimit me qytetarë.

Ajo ka bërë me dije se LDK-ja nuk do ta amnistojë askënd para ligjit. "Qytetarët e Kosovës jo vetëm se do t'i largojnë nga qeveria ata që e keqpërdorën dhe e shkelën mundin dhe djersën e qytetarëve, por ata do të japin edhe llogari para drejtësisë, sepse LDK-ja nuk do ta amnistojë askënd para ligjit", ka theksuar ajo, duke shtuar se për të dhe për LDK-në nuk ka asgjë më të shenjtë sesa beteja

për ta ç'kapur shtetin nga ata që themelet i kanë në krim dhe në korrupsion. "Kur them kurrë me PDK-në, ajo mbetet kurrë me PDK-në. Qytetarët e Kosovës besojnë në shtëpinë e vetme politike, që i ka dalë zot këtij vendi kur ka qenë në rrezik dhe ajo është Lidhja Demokratike e Kosovës", ka theksuar Osmani. Sipas saj, LDK-ja është më e bashkuar se kurrë më parë, për të shënuar fitore sikurse në vitin 2004.

Në këtë tubim ka folur edhe nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka adresuar kritika për ata që

po provojnë ta blejnë vullnetin e qytetarëve. "Ai tipi që e ka hequr sakon dhe i ka përvjelë mëngët, pse nuk i ka përvjel që 20 vjet?! Mbajeni mend, do t'ua nxjerrim ato duar nga kuleta e popullit, sepse e kanë tepruar", ka deklaruar Haziri.

Ndërsa kryetari i Degës së LDK-së në Therandë, Ardian Shala, ka thënë se Theranda ishte dhe do të mbetet kala e fuqishme e LDK-së, e me kryeministren Vjosa Osmani do të forcohet dhe do të shkëlqej.

Kandidatja e LDK-së për kryemi-

nistër, Vjosa Osmani, të premtën ka bërë homazhe te Kompleksi Memorial në Reçak. Me këtë rast ajo ka thënë se liria e Kosovës i ka rrënjët në gjakun e viktimave që humbën jetën gjatë masakrës në këtë fshat. "Lirinë e kemi pikërisht për shkak të këtyre viktimave civile, pikërisht për shkak të sakrificës së këtyre familjeve të cilat humbën më të dashurit e tyre në mënyrë që ne sot ta gëzojmë këtë ditë", ka thënë Osmani. Ajo të premtën ka vazhduar fushatën edhe në Dragash dhe në Prizren.



Kurti në Rahovec premtion mbështetje të madhe për prodhuesit vendorë

RAHOVEC, 27 SHTATOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje të premtën ka mbajtur tubim elektorale në Rahovec dhe ka kërkuar të votohet partia që udhëheq ai. Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se Kosovës i erdhi dita të shpëtojë nga korrupsioni dhe kapja e shtetit. Kurti ka premtuar se në qeverinë e udhëhequr nga ai fermeri do të mbrohet e do të subvencionohet edhe me fondin prej 600 milionë eurosh. "Dita për fermerin e Rahovecit që ta ketë mbrojtjen dhe kujdesin e shtetit tashmë erdhi. Ne do ta mbrojmë grantin e katër qeverisës për komunat në vlerë prej 600 milionë eurosh që ta rrisim prodhimin vendor, ta zëvendësojmë importin dhe të rrisim eksportin. Qeveritë që kemi pasur deri tani e kanë kursyer buxhetin për ekonomitë prodhuese dhe e kanë shpërdorur atë për lukse qeveritare, por erdhi dita që ta ndalim luksin ta luftojmë korrupsionin dhe ta rrisim buxhetin", u shpreh Kurti.

I pari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin



Kurti, ka premtuar ulje të tatimeve dhe bizneseve prodhuese si dhe përkrahje për familjet në gjendje të rëndë ekonomike. Pretendenti për kryeministër të ardhshëm të

Kosovës premtoi 160 milionë euro investim në sistemin arsimor. "Ne do ta heqim tatimin për fitim deri në 300 euro sepse askush nuk duhet të paguajë tatim për të mbi-

jetuar. Familjet që kanë mbetur prapa në këtë ekonomi që nuk punëson dhe nuk prodhon, ne do t'i mbështesim dhe shtesat për fëmijë, me punësim sezonal për

një anëtar të familjes dhe me rimbursim vjetor prej 150 eurosh për secilin fëmijë deri në moshën 16-vjeçare", ka thënë ai.

Kurti, duke iu referuar sloganit "Erdhi dita", ka theksuar se erdhi dita të punohet për shtetin e së drejtës, që lufton monopolin dhe pasurinë e paligjshme. Kandidati për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se më 6 tetor do të kthehet shpresa për ndryshim në rend dhe respektim të ligjit pasi, sipas tij, me udhëheqjen e shtetit nga Lëvizja Vetëvendosje do krijohen institucione të afta të sigurisë.

Selimi ka pohuar se me Kurtin në krye të shtetit, Policia e Kosovës do të gëzojë përfitime që i takojnë dhe bëhet polici e dashur për popullin e tmerr për kriminelin. Kandidati për deputet nga qyteti i Rahovecit, Visar Korenica, ka thënë se qytetarët më 6 tetor do t'i ndëshkojnë ata që abuzuan dhe e vodhën shtetin e Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje tubime elektorale ka mbajtur të premtën edhe në Sharr dhe në Viti.

Limaj: Projekti 'Bashkë për shtetin' po përkrahet fuqishëm anembanë vendit

Nisma Socialdemokrate ka vazhduar të premtën fushatën elektorale në Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime. Kandidati për kryeministër, Fatmir Limaj, ka thënë se projekti "Bashkë për shtetin" po përkrahet fuqishëm anembanë vendit

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Nisma Socialdemokrate ka vazhduar të premtën fushatën elektorale në Shtime, ku nga ky qytet kandidati për kryeministër, Fatmir Limaj, ka marrë mbështetje për projektin "Bashkë për shtetin". Ai ka thënë se ky projekt po përkrahet fuqishëm anembanë vendit.

Limaj në këtë tubim madhështor, në sallën e mbushur me qytetarë, ka shpallur para përkrahësve të Nismës vizionin për qeverisjen e ardhshme dhe projektin "Bashkë për shtetin". "Projekti ynë 'Bashkë për shtetin' thërret njerëzit e mirë të këtij vendi të bashkohen me zemër e me bindje për t'i dhënë

një mundësi ndryshe vendit tonë. 'Bashkë për shtetin', sepse është e vetmja rrugë që ofron e bashkon njerëz. Me projektin tonë fiton Kosova dhe qytetarët e saj!", ka thënë Limaj.

Ndërkaq kandidati për deputet, Endrit Shala, ka thënë se s'ka kush që e ndalë fitoren e Nismës më 6 tetor. Qyteti i Shtimes aq i vogël na befasoni me kaq shumë përkrahës që erdhën sot, na takuan dhe i thanë po projektit tonë 'Bashkë për shtetin'. Me kryetarin Fatmir Limaj dhe me të gjithë anëtarët e Nismës Socialdemokrate që ishim

bashkë në Shtime, u zotuar se do t'u dalim krah qytetarëve të kësaj komune, që janë harruar nga pushteti. Qeveria e Nismës Socialdemokrate do t'ua zgjasë dorën e shtetit secilit qytetar, në secilin cep të Kosovës. Faleminderit Shtime për entuziazmin që na dhurove! Shihemi në fitore", ka thënë Shala pas tubimit elektorale. Nisma Socialdemokrate ka mbajtur të premtën tubime elektorale në Ferizaj dhe Kaçanik, ku ky subjekt politik në këto dy komuna ka marrë përkrahje për zgjedhjet e 6 tetorit.

Madanaj, Rrypaj dhe Rracaj, të mobilizuar për t'i sjellë një rezultat të madh Nismës më 6 tetor

Kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, Fazli Hoxha, i shoqëruar edhe nga zyrtari i lartë i Nismës Socialdemokrate, kandidati për deputet Haxhi Shala dhe kandidatët të tjerë për deputetë të Nismës nga rajoni i Gjakovës, ka takuar anëtarët e nëndegës së Nismës Socialdemokrate në Madanaj, Rrypaj dhe Rracaj. "Nga ky takim pamë se fryma e Nismës Socialdemokrate po shtrihet në çdo fshat dhe lagje të Komunës së Gjakovës. Në këtë takim u theksua se Kosovës i duhet ndryshimi përmes programit socialdemokrat të Nismës. Ka ardhur koha që vendi të qeveriset nga koalicioni Nisma-AKR-PD me kryeministër Fatmir Limaj", ka thënë Fazli Hoxha. Ai ka theksuar se edhe anëtarët e nëndegës së Nismës Socialdemokrate në Madanaj, Rrypaj dhe Rracaj konfirmuan në këtë takim se janë mobilizuar si asnjëherë më parë për t'i sjellë një rezultat të madh Nismës në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit.



Pacolli: Ne s'bëjmë me gisht kah problemet, ne ofrojmë zgjidhje për to

FERIZAJ, 27 SHTATOR (ER) - Kryetari i partisë Aleanca Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka thënë se ai nuk bën me gisht kah problemet, por vjen me zgjidhje për to. "Ne jemi zëri juaj dhe planifikojmë të jemi zëri më i fuqishëm që qytetarët kanë pasur deri më tani", ka shkruar Pacolli në logarinë e vet në "Facebook".

Aleanca Kosova e Re (AKR) para qytetarëve të Ferizajt ka shpallur programin e vet dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e ardhshëm të Republikës së Kosovës.


Tubimin e hapi Ibrahim Hyseni, koordinator i Degës së AKR-së në Ferizaj. Hyseni prezantoi para të pranishëmve dy kandidatët për deputetë nga Ferizaj, ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa dhe Sadat Ismailin.

Duke shpallur prioritetet për qeverisjen e ardhshme katërvjeçare, sekretari i përgjithshëm i

AKR-së, Vesel Makolli, ka premtuar zhvillim në fushën e arsimit, ekonomisë dhe shëndetësisë. Ai ka kërkuar votën për koalicionin AKR-Nisma-PD pasi, sipas tij, vetëm duke e votuar këtë koalicion mund të nxirret shteti nga gjendja e rëndë me të cilën po ballafaqohet.

Kandidati për deputet nga Aleanca Kosova e Re, Islam Pacolli, tha se AKR-ja në krye me Behgjet Pacollin është partia që mund ta luftojë korrupsionin dhe mund ta zhvillojë ekonomisht Kosovën. Pacolli ka ftuar qytetarët që mos të dëgjojnë demagogji, sepse ata që flasin shumë, kurrë nuk kryejnë punë.

Ndërsa kryetari i Partisë së Drejtësisë, Ferid Agani, tha se qytetarët e Kosovës duhet të votojnë ndershmërinë dhe profesionalizmin e koalicionit AKR-Nisma-PD e jo arrogancën e partive të tjera politike.



Miratohet buxheti i Prishtinës për vitin 2020

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar të premten buxhetin për vitin 2020. Buxheti prej 91 milionë eurove ka kaluar me 35

vota për, një abstenim dhe asnjë kundër. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka falënderuar asamblistët për diskutimet rreth buxhetit të cilat

i ka quajtur konstruktive. "Me 35 vota për, një abstenim dhe asnjë kundër kaloi buxheti i Prishtinës për vitin 2020. Falënderoj asamblistët për diskutime konstruktive. Prioritetet e buxhetit prej 91 milionë eurosh do të shpalosen në javët në vijim", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

tive. Prioritetet e buxhetit prej 91 milionë eurosh do të shpalosen në javët në vijim", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



AAK-ja prish koalicionin me PDK-në në Gjakovë

GJAKOVË, 27 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka bërë me dije se është votuar buxheti i kësaj komune për vitin 2020, por pa mbështetjen e asamblistëve të PDK-së. Gjini ka thënë se për shkak të mosvotimit të buxhetit ka prishur koalicionin me PDK-në në Gjakovë. "Sot kaloi buxheti i Komunës së Gjakovës për vitin 2020. Gjatë votimit PDK-ja ishte kundër, gjë të cilën edhe e paralajmëroi. Meqenëse në demokraci koalicionet krijohen për krijimin e shumicës parlamentare, një i tillë nuk ka kuptim nëse shumica dështon. Prandaj sot e kam kërkuar dorëheqjen e të emëru-

arve politikë që vijnë nga radhët e PDK-së. Unë publikisht i falënderoj për bashkëpunimin e deritanishëm", ka njoftuar Gjini.

Ndaj vendimit të Gjinit ka reaguar kryetari i Degës së PDK-së në Gjakovë, Hajdar Beqa, i cili ka thënë se kjo parti është shtetformuese dhe në funksion të interesave të qytetarëve. "Partia Demokratike e Kosovës gjatë qeverisjes së saj ka instaluar standarde të larta menaxhimi, që si prioritet të saj të vetëm ka pasur zhvillimin e vendit, por ka qenë dhe vazhdon të jetë kundër krijimit të dinastive fisnore dhe tendencave zhatëse të kryetarit aktual (Ardian



Gjini), por edhe partisë të cilën ai e përfaqëson. PDK-ja tash e tutje do të jetë zë i fuqishëm opozitar në Komunën e

Gjakovës deri në zgjedhjet e ardhshme lokale, kur dhe do ta marrë qeverisjen në këtë komunë, derisa në ditën e fun-

dit të javës që vjen PDK-ja do ta marrë qeverisjen e vendit në nivel qendror", është thënë në reagimin e Beqës.

Përurohesh hapësira të reja për piknik në Prizren



PRIZREN, 27 SHTATOR (ER) - Me rastin e Ditës Botërore të Turizmit, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me nënkryetarin Eshref Memaj dhe drejtorshën e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz, kanë përuar hapësirat e reja për piknik në Pashaçeshme 3, si dhe kanë inspektuar punimet e shtegut për Downhill që është në ndërtim e sipër dhe që do t'u shërbejë çiklistëve malorë. Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se këto dy këto projekte janë realizuar në kuadër të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe kanë për qëllim zhvillimin e turizmit

malor dhe ofrimin e produkteve të reja turistike. "Me investimet e bëra në Pashaçeshme 3 kjo hapësirë është shndërruar në pikë pushimi, ndërsa në të janë vendosur ulëset dhe tavolinat për piknik, tabelat informuese, si dhe janë mbjellë fidanët dekorues përreth. Ndërsa shtegu për Downhill fillimisht po ndërtohet nga pika fillestare (ruga për në Shtëpinë Malore) e deri te Pashaçeshme 3 me gjatësi rreth 1 km, ndërsa më pas do të vazhdojë edhe ndërtimi i pjesës tjetër që do të arrijë në gjatësi të përgjithshme prej 5 kilometrave", është thënë në njoftimin e Komunës së Prizrenit.

Nis ndërtimi i shkollës së re në Zaskok të Ferizajt

FERIZAJ, 27 SHTATOR (ER) - Në fshatin Zaskok të Komunës së Ferizajt është vënë gurthemeli i objektit të ri të shkollës "Naim Frashëri", e cila ka vlerën e 1.3 milion eurove dhe financohet nga Ministria e Arsimit. Në ceremoninë e vënies së guthemelit kanë marrë pjesë edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, drejtori i Arsimit, Afrim Llabjani dhe drejtorë të tjerë komunalë. Me këtë rast, Aliu ka thënë se është jashtëzakonisht i

lumtur për ndërtimin e shollës së re në Zaskok. "Sigurisht se jam i lumtur edhe për faktin se më në fund po i jepet përgjigjja e duhur një numri shumë të madh të nxënësve për të krijuar kushte që ata të kenë ambiente më të mira mësimi. Sigurisht se krijohen kushte edhe për mësimdhënësit, pedagogët që, po ashtu, ata më mirë ta ushtrojnë profesionin e tyre dhe që mësimnxënja dhe mësimdhënja të jenë në nivel më të ngritur. Kjo shkollë nuk ka

plotësuar kushtet, madje është një prej shkollave më të vjetra në territorin e Ferizajt dhe kjo është edhe arsyeja që ka qenë kërkesë e kamotshme, por ju, siç e dini, ka qenë këmbëngulja jonë, e Komunës së Ferizajt, sipas kërkesës së komunitetit, këshillit të fshatit, prindërve dhe falënderoj qeverinë dhe kryetarin e Kuvendit të Kosovës, që përmes procedurave parlamentare të bëhet pjesë e buxhetit", ka thënë Aliu.



Limaj dhe Shala përurojnë asfaltimin e Zonës Ekonomike në Suharekë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

SUHAREKË, 27 SHTATOR - Zëvendëskryeministri në detyrë, Fatmir Limaj dhe ministri në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, kanë përuruar të premten asfaltimin e Zonës Ekonomike në Suharekë. Me këtë rast, Limaj ka thënë se ky është shembulli më i mirë se si ndihmohen bizneset private. Sipas tij, kjo zonë po kthehet në boshtin e punësimit jo vetëm të Suharekës, por të gjithë regionit. "Tashmë kemi një park ekonomik me një infrastrukturë të duhur, duke përfshirë këtu edhe energjinë elektrike dhe, mbi të gjitha, është lidhja e rrugës me autostradën, në mënyrë që kompanitë të mos kenë nevojë fare të futen nëpër qytet, por mund të lidhen drejtpërdrejt me autostradën. Ky është shembulli më i mirë se si ndihmohen ndërmarrjet e vogla dhe të

mesme. Kjo është politika jonë që ne vijmë e shtrijmë dorën e shtetit, i kryejmë detyrat tona para njerëzve të cilët kanë iniciativën private si parakusht për të hapur vende të reja të punës", ka thënë Limaj.

Ai ka shtuar se ky është veprimi për të cilin ka nevojë Kosova. "Ne nuk do ndalemi. Do të shkojmë në çdo qytet në Kosovë për të ndërtuar parqe të tilla që bizneset të mos kenë më nevojë t'i shpenzojnë paratë e veta për përmirësimin e infrastrukturës të cilat mund t'i kryejë shteti, por të fokusohen në rritjen e prodhimit dhe fuqizimit të bizneseve të tyre. Ndihehem shumë i kënaqur që MTI dhe ministri Shala e kanë përbushur atë premtim që kemi dhënë bashkë, por edhe të gjithë kolegët e tjerë që vazhdimisht janë angazhuar për funksionim të implementimit të këtij projekti", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj.



Ndërsa ministri në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se në këtë zonë janë të vendosur mbi 70 biznese dhe se janë investuar mbi 2.6 mil-

ionë euro. "Kjo zonë ekonomike nga tash është funksionale me gjithë infrastrukturën që u nevojitet bizneseve që ta kenë më të lehtë për biznes. Jemi në një zonë

ekonomike e cila është 160 hektarë, ku janë të vendosura mbi 70 biznese dhe me një investim mbi 2.6 milionë euro nga Ministria e Tregtisë", është shprehur Shala.

Fillon ekzekutimi i subvencioneve në vlerë rreth 11.9 milionë euro

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas kontrollit administrativ dhe kontrolleve në terren, ka përgatitur listat për pagesë të fermerëve përfitues në kuadër të Programit për Pagesa Direkte për vitin 2019. Deri më tani janë proceduar listat për pagesë për 13 697 fermerë, të cilët kanë përfituar subvencione në vlerë prej 11 891 328.14 eurosh. Prej kësaj shume, pagesa direkte për sipërfaqe për personat fizikë, të cilat do të fillojnë të ekzekuto-



hen nga MBPZHR-ja, arrijnë vlerën prej 8 097 061.22 eurosh, ndërkaq për blegtori 3 102

635.00 euro. Pagesat, po ashtu, janë në proces edhe për listën e përfituesve të personave

juridikë - agrobizneseve në vlerë prej 513 842.57 eurosh për sipërfaqe të mbjella dhe pagesa direkte për blegtori për këta persona në shumën prej 181,126.70 eurosh.

Kryeshefi ekzekutiv i AZhB-së, Ekrem Gjokaj, ka thënë se kjo agjenci gjatë gjithë kohës së procesit vlerësues ka qenë dhe do të jetë transparente, me ç'rast i ka informuar fermerët përmes sms-ve dhe vendimeve në e-mail, si dhe përmes ueb-faqes së AZhB-së për rezultatet lidhur me procesin vlerësues. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në programin e sivjetmë ka paraparë subvencione për grurë, për farë gruri, për misër, për elbin, për

thekrën, për luledielli, për lopë dhe buallica qumështore, për dele dhe dhi, për pulari, për bletari, për derrari, për thëllëza, për pemishtet ekzistuese, për perimet në fushë të hapur dhe në serra, për vreshtat ekzistuese, për bujqësinë organike, si dhe për fidanë të pemëve drufrutore dhe hardhi të rrushit. Po ashtu, subvencionim ka edhe për akuakulturën, therjet e raportuara të gjedhit, për qumështin sipas kategorive të cilësisë dhe për verën e prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht, për primin e sigurimit bujqësor, për kulturën bujqësore të mjedrës, si dhe për sasinë e dorëzuar/shitur të duhanit.

Prokuroria në Pejë ngre 34 aktakuza për vjedhje të pyllit

PEJË, 27 SHTATOR (ER) - Koordinator i veprave penale që ndërlihdhen me pyjet dhe ambientin në Prokurorinë Themelore të Pejës, prokurori i shtetit, Ersan Qavolli, ka mbajtur takim me zëvendësdrejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, nënkolonelin Veton Elshanin, komandantët e stacioneve policore, shefat e hetimeve dhe drejtorin dhe stafin përcjellës të Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Gjatë takimit është bashkëbiseduar për koordinimin e mëtutjeshëm për parandalimin e prerjeve ilegale të pyllit në Zonën e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", njëkohësisht për marrjen e përgjegjësisë për identifikimin dhe arrestimin e atyre që bien ndesh me dispozitat e parapara ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera në fuqi. Gjithashtu, ndërlihdhur me këto vepra penale Prokuroria

Themelore e Pejës gjatë periudhës kohore maj-gusht ka ngritur gjithsej 34 aktakuza ndaj 37 personave për veprën penale "vjedhje e pyllit". Gjatë këtij muaji janë ndaluar me aktvendim të prokurorit të shtetit edhe katër pylltarë nën dyshimin se kanë kryer veprën penale "keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar" dhe një person për veprën penale "keqpërdorim i autorizimeve ekonomike".



FUSHATA NUK NDRYSHON ASGJË, KLIENTELIZMI DHE BISEDIMET ME SERBINË JANË PËRCAKTUESE



Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA

Përmbyllja e fushatës: Subjektet dhe koalicionet garuese për zgjedhjet e 6 tetorit 2019 kanë hyrë në fazën e arritjes së efekteve mediale shkaku se të gjitha që kanë pasur t'i thonë i kanë thënë gjatë fushatës ilegale e që ka filluar disa muaj më parë. Partitë kryesore muaj më parë i kanë filluar përgatitjet për zgjedhje dhe vetëm ka pasur paqartësi se kush me kë do të bëjë koalicion. Në një masë edhe koalicionet e mundshme dhe të pamundshme ishin projektuar më parë disa për të mbijetuar politikisht dhe jo vetëm politikisht, disa sepse vlerësuan se do të forcoheshin e që nuk është ashtu, së paku ashtu mendoj, por se kjo nuk nënkupton se kam të drejtë! Pasi u shpërnda tymi, që në ditën e parë të përmbylljes së fushatës, më 25 shtator, e kemi një situatë që më shumë është mashtrimi optik sesa që paraqet gjendjen reale, fuqinë politike apo disponimin e votuesve. Realisht, para këtyre zgjedhjeve të parakohshme u bënë disa lëvizje apo llogaritë që nuk dolën dhe as që do të dalin ashtu si kanë menduar dhe planifikuar subjektet politike. E mira e kësaj situatë është se tash kemi katër (4) parti politike apo koalicione që shprejnë dhe besojnë se do t'i fitojnë zgjedhjet dhe se, sipas parashikimeve, ta themi të kësaj dite, dallimi midis tyre në vota është i vogël, midis fituesit, të dytës dhe të tjerëve. E keqja e kësaj situatë është se, kushdo që të jetë fitues i zgjedhjeve dhe çfarëdo përbërje të qeverisë së re, nuk do ta ketë prioritet e as mundësi të përmbushjes së premtimeve elektorale për faktin se, sipas atyre që vranë e kthjellin në Kosovë, prioritet mbi prioritetet është vazhdimi i bisedimeve me Serbinë dhe arritjen e një marrëveshjeje, siç po e quajnë detyruese. Kjo nënkupton se edhe koalicioni pas zgjedhjeve do të jetë në funksion të këtij qëllimi ndërkombëtar dhe se politikanët kosovarë që do të jenë pjesë e bisedimeve dhe mar-

rëveshjes duhet ta kenë besimin dhe duhet të jenë jashtëzakonisht fleksibilë apo të dëgjueshëm, sipas Fjalorit të gjuhës shqipe. Andaj, nuk kanë fare kuptim këto denoncime, premtime dhe mashtrime që po u bëhen votuesve dhe opinionit kur, në fund të fundit, koalicionet nuk i cakton Kanuni i Lekës, por ndonjë administrator i ligës së tretë i Trampit apo ndonjë mbetje mortore politike e BE-së siç ishte puna e Mogerinit. Po gabohemi rëndë kur po mendojmë se bota po sillet rreth nesh dhe se puna e parë që e bëjnë Uashingtoni dhe Brukseli kur të zgjohen në mëngjes është të pyesin se si e kemi Kosovën?! Që nga përfundimi i luftës në Kosovë politikën në vendin tonë nuk e kanë udhëhequr kosovarët, por se e kanë udhëhequr Serbia dhe ndërkombëtarët! Është një nonsens që, përkundër fakteve që i kemi, nga një viktimit absolute, jemi shndërruar në një dhunues absolut në kohën kur një kriminel absolut luftë si puna e Aleksandar Vuçiqit dhe Ivica Daçiçit, nga përkrahës dhe pjesëmarrës aktivë në krime lufte dhe krime kundër civilëve shqiptarë, janë shndërruar në viktima dhe përcaktues vendimmarrës për punë që janë ekskluzivisht përgjegjësi e Kosovës. Sot Aleksandar Vuçiqi është bërë partneri numër një i evropianëve sikur që po i hapen dyert edhe në Uashington, ndërkohë që me ne takohet Johanes Han kur është në gjendje të një dehjeje pak më të menaxhueshme dhe Frederika Mogerini kur është në një gjendje të një frustrimi mesatar. Nuk e di nëse ka fatkeqësi më të madhe për Kosovën dhe shqiptarët nëse ndërkombëtarisht përfaqësohen nga një joprofesionist dhe diletant i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare, por shumë i shkathët në mbrojtje të intereseve personale siç është miku im, Gjeti! Prandaj, për mua nuk ka asnjë kuptim kur në kohën kur na duhet një mobilizim i përgjithshëm për ta bërë sa më të vogël dhe më të durueshëm dëmin që i është bërë Kosovës, kemi aq shumë përçarje midis subjekteve politike dhe ftesa përjashtuese. Ta shohim gjendjen e partive politike aktualisht:

1. Lidhja Demokratike e Kosovës: Është një parti tradicionaliste dhe pjesëmarrëse në të gjitha proceset politike në të cilat ka kaluar Kosova. Do të jetë pjesë

edhe e proceseve të ardhshme dhe nuk do të përjashtohet nga dialogu sepse nuk e lënë jashtë dialogut. Isa Mustafa e shpëtoi partinë nga ndarja e thellë, por se nuk i dha kapacitet të qëndrueshëm dhe vendimmarrës. Deri më tani thuaja nuk ka pasur, as ofertë politike dhe as ofertë ekonomike apo zhvillimore. Vjosa Osmanin e kanë viktimizuar për t'i ruajtur të mëdhenjtë që do të dalin pastaj në skenë. Vjosa Osmani së paku deri tani nuk ka ofruar asgjë përveç refuzimit të bashkëpunimit me PDK-në sikur edhe porosisë kanunore se, "kur ajo thotë kurrë me PDK-në atëherë mbetet kurrë". Nuk ka asgjë më qesharake se kur një subjekt politik përkatësisht organi kryesor (Këshilli i Përgjithshëm) merr vendim se "nuk ka koalicion me PDK-në...". Është normale nëse do të merrte vendim se do ta mbrojnë integritetin territorial dhe pavarësinë e Kosovës e që nuk e kanë bërë. Shumë herë patën dhënë deklarata të tilla dhe gjithmonë kanë përfunduar në koalicion me PDK-në. Vjosa Osmani po e konsideron veten sikur të ishte Evita Peroni e Argjentinës, Angela Merkel e Gjermanisë apo Margaret Theçeri e Mbretërisë së Bashkuar. Është e magjepsur nga reflektorët dhe posti i kryeministrit. Vjosa Osmani është në pozitën e të dënuarit të cilin e kanë në dorë ata që e dënuan sepse më parë ishte përjashtuar nga këta që sot, për interesa të veta, po e promovojnë politikisht. Vjosa Osmani bëri emër duke e kundërshtuar Isa Mustafën, kurse sot po përpiqet të bëjë emër duke kundërshtuar Kadri Veselin, Albin Kurtin, Zog Ahmetin, Ramushin dhe Fatmirin. Kadri Veselin po e përqesh kur ky thotë se e lufton korrupsionin dhe nuk i beson por, në të njëjtën kohë, u beson bijve dhe bijave që qençe i kanë shërbyer Titos, Rankoviqit, Sllobodan Millosheviqit dhe Rrahman Morinës. Këtu diçka nuk është në rregull. E sulmon Zog Ahmetin se nuk ka guxim sepse ka pasur frikë nga Albini të dërgojë lule te varri i Him Govës. E pse do të duhej të dërgoheshin lule tek ai varr dhe pse ky do të ishte kusht për koalicion?! Askush nuk mund dhe nuk duhet ta gjykojë, as Vjosën e as të tjerët pse shkojnë te varri, por askush nuk mund të kërkojë dhe kushtëzojë askënd për

bashkëpunim me shkuarje tek ai varr. Nëse një subjekt politik kërkon vota nga varri, nga Gjykata raciste Speciale, nga vrasjet e pasqaruara pas luftës për të cilat nuk bëri asgjë, edhe pse i kishte të gjitha mundësitë dhe në bazë të vendosjes së vijave të kuqe atëherë e bënë këtë sepse nuk ka asnjë ofertë serioze për votuesit. Për publikun dhe për votuesit është shumë me rëndësi oferta për hapje të vendeve të reja të punës, përmirësimin e gjendjes në arsim, shërbime më të mira shëndetësore dhe sigurime shëndetësore, drejtësi profesionale dhe të pavarur, të ardhura të mira dhe të garantuara, kushte më të mira të të bërit biznes, pensione të dinjitetshme dhe këtë nuk po e bën Vjosa Osmani. Menyja ofertuese, së paku deri më tani e LDK-së, është e dobët dhe pa përmbajtje. LDK-ja po jeton me të kaluarën sepse partia është e uzurpuar nga një kastë klienteliste, e kriminalizuar dhe e pasuruar, prandaj nuk duhet t'u besohet kur flasin për partnerët me të cilët do të bëjnë apo nuk do të bëjnë koalicion. Ta presim 6 tetorin dhe pastaj flasim. Por, definitivisht, Vjosa Osmani nuk është personi vendimmarrës në LDK për koalicione paszgjedhore dhe ajo mundet, në shenjë mospajtimi, vetëm të ofrojë dorëheqje. Po më habit shumë miku im Ismet Beqiri të cilin në LDK e kanë cullakosur nga të gjitha postet dhe perspektiva politike, kurse ai ende e përdorë një turbo fjalor kundër të gjithëve. Shiheni listën e LDK-së sa lart janë renditur bijtë dhe bijat e atyre që i kanë shërbyer ish-Jugosllavisë kundër Kosovës dhe interesave kombëtare kurse Ismeti, që unë e njoh si një aktivist dhe patriot që nga vitet 1990, po bie në listë poshtë e më poshtë, derisa ta prekë fundin! Nuk besoj se Vjosa Osmani do të bëhet kryeministër por, nëse bëhet, do t'ia uroj publikisht dhe do ta përkrah deri kur mendoj se e meriton përkrahjen time. Por, LDK-ja nuk e ka asnjë të drejtë t'i akuzojë të tjerët, PDK-në në radhë të parë për kapje të shtetit sepse bashkë e kanë kapur, nëse qenka shteti i kapur! Nëse e bëni një skanim të posteve të larta në borde, në agjenci të varura dhe në diplomaci, do të shihni sa shumë janë të LDK-së e që janë në lidhje të ngushta familjare pikërisht me këta që po vizatojnë vija të kuqe, pa u skuqur aspak për dyfytërsinë e tyre!

2. Partia Demokratike e Kosovës: Aktualisht është e vetmja parti që po bën fushatë 100 për qind në frymën rugoviane. Të gjithë e sulmojnë dhe të gjithëve ua kthen faqen tjetër për ta goditur, por nuk përgjigjet me dhunë. Është palosur 100 për qind si taksa e Ramushit. Po bën politikë të mençur, mbi lëkurën e ujkut e ka vendosur lëkurën e qengjit! Dikush po e mëson mirë, madje shumë mirë. Po thonë se e ka angazhuar një kompani që ka planifikuar dhe udhëhequr fushatat e Aleksandar Vuçiqit dhe Edvin Ramës e të cilët fituan bindshëm në zgjedhjet në Serbi dhe Shqipëri. A nënkupton kjo se edhe PDK-ja do të fitojë në Kosovë?! Lehtësisht mund të ndodhë kjo. PDK-ja e ka rritur mobilizimin në shkallën 100 për qind duke i kthyer në grigjë veteranët e larguar më parë dhe duke e pasuruar listën me personalitete të reja. Sipas vlerësimit tim, lista e LDK-së është 100 për qind në rregull sa i përket kriminalitetit (të pazbuluar), kurse lista e PDK-së është 95 për qind e pastër. Është shumë e vërtetë se PDK-ja ka bërë më së shumti ndërhyrje të thella kirurgjike në trupin e partisë e që ka qenë, sa e domosdoshme, aq edhe e rrezikshme. Nuk është njëjtë si ta kapësh për koç... Sami Lushtakun e PDK-së apo Driton Selmanajn e LDK-së?! Dallimi në reagim është shumë i madh edhe për nga intensiteti, vëllimi, vrazhdësia apo edhe rreziku. E di se kur patën filluar kundërshtimet e hapura kundër ish-atdheut të disa politikanëve të sotëm kosovarë, Jugosllavisë dhe Serbisë, na konsideronin të çmendur sepse kishim hyrë në luftë me një shtet që eksportonte armë dhe dhunë në Amerikën e Jugut, Azi, Afrikë dhe Lindje të Mesme, Jugosllavi. PDK-ja, gjatë fushatës rugoviane, as nuk po shkoi te varret e Adem Demaçit dhe Adem Jasharit, personalitete kombëtare dhe politike të 1000 vjetëve të historisë nga të cilët u frymëzuan dhe me të cilët edhe luftuan bashkë kundër Jugosllavisë dhe Serbisë, por po ofron bashkëpunim me të gjithë, pa përjashtime dhe nuk shfaq asnjë hakmarrje. Kadri Veseli është dashur t'i heqë nga lista nja pesë persona për të na bindur se është kundër nepotizmit dhe korrupsionit, por besoj se nuk ka pasur hapësirë për këtë por se, pa asnjë dyshim, do t'i marginalizojë dhe do t'i zhveshë nga çdo

vendimarrje. Kadri Veseli është dashur të jetë shumë më energjik në Besianë dhe t'i largojë ata që ia minuan degën e partisë dhe ia bënë bërë. Aktualisht Besiana është pa potencë politike dhe elektorale për PDK-në pikërisht për shkak të këtyre lojërave. Habitem kur lexoj se PDK-ja e ka opozitën e garantuar dhe se do ta zë vendin e tretë. Sipas analizave që i bëj dhe rrethanave aktuale, në asnjë variant nuk e shoh PDK-në nën vend të dytë dhe jashtë qeverisë së ardhshme. Realisht, në këto rrethana, po të isha kryetar i PDK-së, vullnetarisht do të shkoja në opozitë dhe në asnjë rrethanë nuk do ta pranoja postin e kryeministrit apo t'i udhëheqja bisedimet me Serbinë. Të qenit në opozitë në këto rrethana është gjëja më e mirë, më e shëndetshme dhe investim strategjik fitimprurës për të ardhmen e partisë. Po a e bën këtë PDK-ja vullnetarisht?! As në ëndërr nuk e besoj se kjo mund të ndodhë! Pikërisht këtë e konsideroj si mungesë të vizionit politik të PDK-së. Por, kam filluar të besoj se PDK-ja e ka seriozisht procesin e reformave brenda partisë sikur që edhe mund ta luftojë korrupsionin, me disa ndryshime të mëvonshme! Sa i përket nepotizmit të shprehur në listat për deputetë, LDK-ja është kampione absolute, pas së cilës vjen PDK-ja, kurse partitë e tjera janë të pastra.

3. Lëvizja Vetëvendosje! Është në pozitën më të vështirë. Sa nuk

bënte ndryshime akuzohej pse nuk po i bënë, tash kur ka bërë shumë ndryshime po e fajësojnë për dyfytërsi! Hyp se t'vrava, zhdryp se t'vrava. Po e akuzojnë se nuk po e përdorë flamurin e Kosovës, por atë kombëtar e që është edhe flamur i Shqipërisë. Është kohë shumë e shkurtër që LV-ja ta bëjë këtë kthesë; nëse do ta bënte do t'i humbiste votat kuqezi dhe nuk do të fitonte asnjë votë të flamurit të Tinës (Kajdanov). Albini ka deklaruar se nëse bëhet kryeministër, do t'i respektojë simbolet e Kosovës e që për mua është gabim i madh dhe i kushtueshëm. Me vetë faktin se jeni pjesë e institucioneve të shtetit (qoftë edhe i lodhtë) të Kosovës, domosdoshmërisht nënkupton se duhet t'i respektoni ato simbole e jo edhe t'i duani! Nuk ka respektim të kushtëzuar, por ka respektim të obliguar. Këtë duhet ta ketë të qartë edhe Albini. Nëse Albini do të bëhet kryeministër, e që nuk e besoj se do të bëhet, atëherë domosdoshmërisht do të bëhet pjesë e skemës së fleksibilitetit gjatë bisedimeve me Serbinë ose për të do të jetë si "game over" (përfundim i lojës). Sot LV-ja, përjashtuar 3-4 persona që kanë përfaqësim të denjë dhe mesatar, ka mungesë të madhe të kapacitetit debatues prandaj, Albini, si Jezu Krishti, tërë barrën po e bartë në supet e veta rrugës drejt Golgotës apo përfundimit të procesit zgjedhor. Në momentin e fundit LV-ja, në planin e përfaqësimit në debate

ku kërkohet profili i lartë intelektual, u forcua dukshëm me Agim Bahtirin. Kurse disa që po flasin në emër të LV-së më mirë do të bënin të mos flasin fare dhe në këtë mënyrë do t'i bënin shërbimin më të madh LV-së dhe do ta amnistionin veten nga të kuptuarit publik se janë injorantë të papërmirësueshëm! Nuk besoj se LV-ja shkon përtej vendit të tretë dhe nëse ndodhë e kundërta, atëherë qartazi vërtetohet se jam ndër lule!

4. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe partia socialdemokrate e Katjushës: Pagaron në këto zgjedhje me tak-sën kundër mallrave të Serbisë dhe Bosnjës të përkthyer në 100 për qind shtet. Nuk kam dyshim se do të ndahet mirë në këto zgjedhje. Mund edhe të mos pajtoheni me mua, por jam shumë i sigurt se procesin që e filluan i biri i Fahriut dhe i biri i Haxhiut për këmbim të territoreve e ka penguar dhe ndaluar pikërisht Ramush Haradinaj apo Rambo Glligjani. Nëse asgjë tjetër nuk ka bërë gjatë këtyre katër semestrave të qeverisjes, kjo i mjafton dhe kjo e arsyeton sepse, në të kundërtën, Agim Bahtiri nuk do t'i binte çiftelisë në Mitrovicë. Ka një listë të mirë dhe të respektueshme dhe që e dallon prej partive të tjera dhe ka një përfaqësim të mirë gjinor si për nga cilësia e përfaqësimit politik, po ashtu edhe në aspektin vizual, duke ofruar ide dhe sharmë në këtë listë.

5. Lista Serbe: Është parti socialshoviniste e Serbisë në Kosovë e cila, përveçse përfaqëson Serbinë fashiste në Kosovë 100 për qind, gjithashtu 100 për qind i terrorizon edhe serbët e Kosovës që nuk duan të vallëzojnë sipas muzikës së Vuçiqit dhe Daçiqit. Vetëm Kosova, si shtet shumë i lodhët, do të duronte një çetnik si puna e kryetarit të Zubin Potokut, që pamëshirshëm e shkërdhen buxhetin e Kosovës e që deklaroi se: "me tabelë apo pa tabelë, Zubin Potoku është territor i Serbisë..." Në vend që të arrestohet për rrezikim dhe mohim të shtetit të Kosovës, ky farë idioti shpërblehet nga Kosova me një rrogë të majme dhe përfitime të tjera që nuk i ka as ati Amfillohi. Serbët e Kosovës që e pranojnë Kosovën janë integruar në institucionet e Kosovës dhe nuk vallëzojnë sipas Beogradit e as nuk ka kush t'i mbrojë; as shteti i Kosovës nuk e bën këtë, as BE-ja e as nuk kemi votues aq të vetëdijshëm që të votojnë për ta në mënyrë që ta shkërdhejnë Listën Serbe.

Përfundim: Në mungesë të ofertës politike, Vjosa Osmani ishte në Prekaz ku Himë Gova asnjëherë nuk pranoi të shkante sepse ishte i vogël dhe i papërfillshëm para veprës dhe sakrificës së pamatë të Komandantit Legjendar, Adem Jashari. Nuk ka gjë më të pamoralshme se kur bëni përpjekje t'i vendosni në një rrafsh

Komandantit Legjendar, Adem Jasharin, komandantit e sakrificës sublime dhe komandantit e nënshtrimit, Ibrahim Rugovën. Nuk e them se Rugova nuk e ka dashur lirinë dhe pavarësinë e Kosovës apo se ka qenë njeri i keq, por e them se, sa për Rugovën dhe Vjosën me kompani përcjellëse, në Kosovë edhe në 500 vjetët e ardhshëm nuk do të kishte luftë dhe se do të bëhej që nënshtrimi të zyrtarizohej si filozofi politike dhe shtetërore. Këtë skemë të nënshtrimit e prishën përgjithmonë ushtarët e lavdishëm të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, ata që kaluan nën torturë shekuj dhe shekuj burgim në llogoret e ish-Jugosllavisë, ata që mbi çdo interes partiak apo personal e kishin idealin e lirisë dhe, mbi të gjitha, arkitektët dhe zbatuesit e kësaj lirie: Hasan Prishtina, kryegjeniu i politikës kombëtare dhe Adem Demaçi, zbatues i bindur i kësaj politike sikur edhe Adem Jashari, me bashkëlufttarë që sakrificën për liri dhe çlirim e bëri mënyrë të të jetuarit dhe të vepruarit! Nuk kam dyshime se, në rast nevojë, edhe sot do të luftonin për Kosovën Ramush Haradinaj, Kadri Veseli dhe Albin Kurti. Nga LDK-ja nuk besoj se, përveç Dritonit, Lumirit dhe Avdullahut, ndokush tjetër do të bënte luftë çlirimtare. Nga Nisma për Kosovën do të ishin vetëm dy komandantë që do të luftonin, Zafa dhe Gjet Pacolli!

UPZ-ja LIDH MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN SHTETËROR TË TIRANËS DHE UNIVERSITETIN EVROPIAN TË TIRANËS

Prizren, 27 shtator (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe Universitetin Evropian të Tiranës. Marrëveshje përkatëse është lidhur të enjten gjatë vizitës që ka zhvilluar rektori Temaj dhe prorektori Nimani me bashkëpunëtorë në Tiranë në takime të ndara. Universitetet do të zhvillojnë bashkëpunim në fushën e arsimit, kërkimit dhe fushat e tjera të interesit të dyanshëm, të vendosin projekte kërkimore të përbashkëta dhe t'i kryejnë raportet e përbashkëta, të përfshijë punonjës akademik nga pala tjetër në aktivitete kërkimore, të organizojnë së bashku kërkime akademike rreth temave të përcaktuara më parë, shkëmbejnë informacione akademike, organizojnë kurse të përbashkëta afatshkurta dhe me afat të gjatë dhe seri leksionesh mbi tema të përcaktuara më

parë, të shkëmbejnë përvoja rreth procesit të mësimdhënies dhe metodave në mënyrë që të përmirësohet efica e studimit, të shkëmbejnë studentë për kurse apo praktika etj. Palët mund të organizojnë programe diplomimi për specialist dhe për diploma masteri dhe, gjithashtu, borde vlerësimi të rëndësishme për përgatitjen dhe mbrojtjen e disertacionit të doktoratës. Palët mund të shkëmbejnë anëtarë të fakulteteve për studimet e postdoktoratës sipas parimit të reciprocitetit. Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, e ka vlerësuar lart arritjen e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke theksuar se do të shkojnë në funksion të arritjes së objektivave për bashkëpunim konkret me universitetet në regjion dhe më gjerë. Prof. dr. Mynyr Koni, rektor i Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe prof. dr. Nevila Nika, rektor i



Universitetit Evropian të Tiranës, po ashtu e vlerësuan lart arritjen e kësaj marrëveshje dhe theksuan se kjo marrëveshje shkon në kuadër të arritjeve dhe

interesave të përbashkëta në fushën e arsimit të lartë. Gjatë vizitës delegacioni nga UPZ-ja vizitoi edhe Ambasadën e Republikës së Kosovës në

Tiranë, ku u takuan me sekretarin e kësaj ambasade, Adem Sallauka, i cili ka shërbyer si sekretar i përgjithshëm i UPZ-së kohë më parë.

E jashtëzakonshme

Rusia ndalon pirjen e duhanit në ballkonet e apartamenteve

Një rregull i ri është miratuar në Rusi. Duhanpirësit rusë nuk lejohen më të tymosin në ballkon. Ministria e Emergjencave ka njoftuar se pirja e duhanit është ndaluar në ballkonet e apartamenteve si dhe në vendet e banimit të konvikteve dhe hoteleve, kjo për arsye sigurie. Shkrepëset, qirinjtë dhe pirja e duhanit klasifikohen si rrezik për zjarret. "BBC" shkruan se fillimisht kishte



konfuzion nëse edhe pirja e duhanit do të përfshihej në rregullat e reja, por më vonë zyrtarët konfirmuan se edhe pirja e duhanit do të ndalohej. Thyerja e rregullave të reja të sigurisë mund të shkaktojë një gjobë deri në 3 000 rubla (ose 42 euro).

FOTO E DITES



Një bretkosë shihet në një gjethe të zambakut pas shiut në një pellg në Lalitpur në Nepal. /Reuters/

E rrallë

Do të gjobiteni mbi 2 700 dollarë nëse nuk shëtisni qentë

Pronarët e qenve mund të gjobiten 2 700 dollarë nëse nuk shëtisin kafshët e tyre të paktën një herë në ditë. Ky ligj funksionon në Australi, kryesisht në zonën "Australian Capital

Territory". Projektligji për Ndryshimin e Legjislacionit të Mirëqenies së Kafshëve, i cili u miratua si ligj të enjten, vendos një sërë dënimesh të rrepta në një përpjekje për ta përmirësuar



mirëqenien e kafshëve. Pronarët do të përballen me gjoba nëse nuk u sigurojnë kafshëve strehë, ushqim dhe ujë.

BARSOLETA E DITËS



- Mami, mami, shokët tallen me mua. Më thonë se kam këmbë shumë të mëdha.
- Bëjnë shaka, shpirti i mamit, mos ua vër re! Hajt tash, shko parkoju këpucët në garazh se do të hamë drekë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
Do të kaloni një ditë të këndshme

dhe të mbushur me pozitivitet, megjithatë tregohuni të vëmendshëm ndaj personave reth jush.



DEMI
Do të jeni të mbushur plot energji

gjatë kësaj të premte. Do të mund të përfundoni thujtë të gjitha detyrat që kishit planifikuar.



BINJAKËT
Profionalisht do të ndiheni të kompletuar

dhe vlerësimet nuk do të mungojnë nga shefat tuaj. Çiftet e kësaj shenje do të kalojnë një ditë të qetë.



GAFORRJA
Mund të përballeni me një situatë të re sot, të cilën do ta keni paksë të vështirë ta zgjidhni. Megjithatë, përpjekjet tuaja të shumta do të shpërblehen.

re sot, të cilën do ta keni paksë të vështirë ta zgjidhni. Megjithatë, përpjekjet tuaja të shumta do të shpërblehen.



LUANI
Ndoshta mund të mos ndiheni aq energjik saç

e prisnit sot, teksa ju preft një ditë tejet e ngarkuar. Një fjalë e gabuar mund t'ju vështirësojë edhe më tej situatën.



VI RGJËRESHA
Nuk është dita e duhur për ta marrë rolin e liderit. Ndoshta e dini mjaft mirë që kjo nuk është ide e mirë, por ju tundon pafund.

marrë rolin e liderit. Ndoshta e dini mjaft mirë që kjo nuk është ide e mirë, por ju tundon pafund.



PESHORJA
Nëse dëshironi një punë të re, është koha e duhur për të provuar. Edhe nëse nuk do të merrni atë çfarë kërkonti, mos u demoralizoni, pasi kjo mund t'ju ndihmojë për të ardhmen.

e duhur për të provuar. Edhe nëse nuk do të merrni atë çfarë kërkonti, mos u demoralizoni, pasi kjo mund t'ju ndihmojë për të ardhmen.



AKREPI
Do të jeni mjaft i përqendruar në punën tuaj sot dhe do të mund të përfundoni çdo gjë që keni parashikuar. Sa i përket anës personale, ka gjasa që një çështje në familje t'ju mendojë dhe të kërkojë kohë për t'u zgjidhur.

përfundoni çdo gjë që keni parashikuar. Sa i përket anës personale, ka gjasa që një çështje në familje t'ju mendojë dhe të kërkojë kohë për t'u zgjidhur.



SHIGJETARI
Nuk do ta keni gjendjen e duhur emocionale sot. Mund të ndiheni paksë të mërziut, por kjo do të jetë vetëm për pjesën e parë të ditës.

sot. Mund të ndiheni paksë të mërziut, por kjo do të jetë vetëm për pjesën e parë të ditës.



BRICJAPI
Kjo ditë do të kalojë shumë shpejt dhe qëllimi juaj do të jetë të përfundoni gjithçka në kohë. Ekziston mundësia e një debati të vogël në punë, por do ta konsideroni si të parëndësishëm.

qëllimi juaj do të jetë të përfundoni gjithçka në kohë. Ekziston mundësia e një debati të vogël në punë, por do ta konsideroni si të parëndësishëm.



UJORI
Besimi në vetvete po ju rritet nga dita në ditë, teksa jeni përshtatur me rregullat e reja. Tashmë jeni në kërkim të perspektivave të tjera.

ditë në ditë, teksa jeni përshtatur me rregullat e reja. Tashmë jeni në kërkim të perspektivave të tjera.



PESHQIT
Mund ta keni të nevojshme të bëni pushim në punë. Mos hezitoni ta kërkonti një gjë të tillë, pasi në të kundërt mund t'ju përkeqësohet gjendja juaj fizike.

pushim në punë. Mos hezitoni ta kërkonti një gjë të tillë, pasi në të kundërt mund t'ju përkeqësohet gjendja juaj fizike.

REXHEP HOXHA, KLASIKU I FUNDIT I LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË E TË RINJ



Prof. Dr. Xhahid BUSHATI

Rexhep Hoxha, shkrimtari nga Kosova, ndërroi jetë në moshën 90-vjeçare (1929 -12.07.2019). Ishte shkrimtari më i moshuar i letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Në qoftë se do t'i kërkojmë rrënjët dhe fillosat e tij letrare, do të thoshim se Hoxha i takonte brezit të parë të shkrimtarëve shqiptarë në Kosovë, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Çka do të thotë se, ishte njëri nga krijuesit më të popullarizuar për lexuesit e vegjël në Kosovë, madje njëri nga themeluesit e letërsisë për fëmijë në këtë trevë. Siç është quajtur nga kritikë e studiues me të drejtë: "Rexhep Hoxha ishte një klasik i letrave shqipe të Kosovës". Shkrimtari Rexhep Hoxha e botoi librin e parë me vjersha të titulluar "Gjethet e reja", 66vjet më parë. Në librat që shkroi më pas, edhe te poemat, edhe te fabulat solli përherë "gjelbërim" poetik në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj. Erdhi me një profil të veçantë. Shquhej për një gëzim të brendshëm krijimi i tij, të cilin e ruajti kurdoherë të tillë. Në udhëtimin e këtij gëzimi dhe këngëzimi, rrezet e diellit të poetëve të Rilindjes ia shndritnin herë pas here vjershat, por pa i cenuar personalitetin artistik. Me kohën lidhi një pakt që, gjithashtu nuk e ndryshoi. Dhe ai ishte: Rrëfimi i natyrshëm, pa sforco e dinjitetshëm i lirizmit poetik. Po ashtu edhe hapësirat e Atdheut: me trimat, me plagët, me dhimbjen, me dashuritë, me ëndrrat, me amanetet, me... Këto tematika

mbeten piketat kryesore të poetikës së tij. Kujtesa poetike e Rexhep Hoxhës ishte një produkt interesant që duhet studiuar për specifikën e saj.

E njohu për së mbari botën e psikologjinë e fëmijës. Elementet edukative të kësaj moshë. Jo më kot, vjershat në palcat e tyre kanë: kureshti, lojë, humor, fjalë pafund onomatopeike, lirizëm, gurrë folklori etj. Kujtohuni për këto emërtesa që po i përmend, që nuk janë gjë tjetër veçse kodet e përkëdhelive të botës fëmijërore dhe domethëniet e zemrës së poetit, si: "Picimuli", "Mbi krahët e fluturës", "Pika vese", "Lulëzo vendi im", "Micimiri", "Piperku", "Zogu i qiellit" etj.

Një kod i rëndësishëm i zhvillimit të poezisë

Në lidhje me veçoritë e krijimtarisë poetike të Hoxhës, paraqesin interes edhe dy shqyrtime të studiuesit Ramazan Çadri dhe shkrimtarit Anton Pashku. Ramazan Çadri shprehet: "...vjershat e Rexhep Hoxhës fitojnë gjallërinë dhe freskinë e nevojshme poetike në saje të konkretësisë së rrëfimit e të përshkrimit të dukurisë a ngjarjes në frymën e këngëve popullore, te të cilat ai u mbështet për të marrë më shumë sesa motivet, thjeshtësinë e të shprehurit, mënyrën gazmore të të rrëfyerit, karakterin lodrues të veprimit si dhe muzikalitetin e ritmit të tyre." Kurse Anton Pashku e cilëson magjinë e poetit në këtë mënyrë: "Kudo nëpër poezitë e tij gjejmë vargje të lëmueta, tinguj që kumbojnë freskët, vjersha që

në vetvete kanë ritëm të mrekullueshëm e humor jashtëzakonisht të qëlluar".

Mes leximeve të opusit krijues të Hoxhës, ndeshim edhe gjykimet e recensuesit Ramadan Musliu. Intenca edukuese e poezisë së Hoxhës, për të cilën shprehet ai, na dritëson një kod të rëndësishëm të zhvillimit të poezisë së Rexhep Hoxhës, ku "problemi i tendencës edukative është i pranishëm edhe si formë e plasimit të një norme, ku shpesh "moral" dhe tendenca edukative shkrihen në tekst me komponentët e tjerë, duke dalë si një imperativ imanent i tekstit poetik", dhe më tej ai thotë se "sa u përket aspekteve ritmike-metrike, ku Rexhep Hoxha i ka veçoritë dalluese nga e gjithë kjo klasë krijuesish, të themi shkarazi se edhe këtu autori ndjek paradigmen e ritmit të rregullt dhe rimës efektive, që është në përputhshmëri me ritmin e ngjarjes së rrëfyer. Nëse i vështrojmë me vëmendje këto kualitete, lirisht mund të konstatojmë se autori është në vazhdimësi e një tradite të tij të ngulitur në kultivimin e vlerave të vargut klasik".

Edhe studiuesi Fatmir Terziu e ka një vështrim të poezisë së Hoxhës në raport me kohën. Ai thotë se Rexhep Hoxha është një nga shkrimtarët që i dhuroi kohës debatin real të komunikimit intelektual dhe vlerës së lidhjes autor-lexues mjeshtrinë e komunikimit. ...Poezia e Rexhep Hoxhës dallohet nga tri lidhje që pasojnë formën didaktike të saj. Lidhja e parë e saj është një arsye që vjen nga shkrimi me energji

dhe vull nëpërmjet rrjedhave të jetës si një pasqyrë e reales sublime ku diktohet forma dhe hapësira si një mekanizëm sintaksor në hapësirën e komunikimit me lexuesin. Lidhja e dytë është ndikimi i ardhur mes arsyes së lidhjes së mesazhit me faktorin lexues, ku komunikimi didaktik i saj kalkulon dhe pohon termin kohë dhe hapësirë duke e kthyer qëllimin poetik në një periudhë të ndikuar, ku udhëzimi, mbetet për një kënaqësi. Lidhja e tretë, ajo më kryesorja që shihet te ky poet është e lidhur me faktin që ka vetë misioni i poezisë së tij si një 'muzë didaktike' për moshat që ai e referon atë, thekson Terziu.

Gjinitë e zhanret e lëvuara i dhanë lavdinë


Prozatori Rexhep Hoxha është autor edhe i romaneve "Lugjet e Verdha" (1959), "Verorja" (1984), "Ermali" (2000). Këto tri romane, më shumë i pari dhe i dyti, më pak i treti, kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe të krijuesve, të cilët herë pas here në kohë kanë dhënë mendimet e tyre. Krahas veprave të njohura nga ana ime dhe qëmtimeve e shqyrtimeve letrare që kam bërë, mendoj që marrëdhëniet e tyre (të studiuesve) lidhur me sagën romanore të Rexhep Hoxhës, duhen grupuar në këtë mënyrë: - autorë që janë ndalur te përmbajtja (subjekti) e librit dhe e kanë rrëfyer atë shpesh imtësisht; - autorë që tentuan të hynin në tipologjinë e romaneve të autorit; - autorë, - dhe kjo me vlerë, - që këndvështruan statusin e romaneve të Hoxhës, si veçori bindëse.

Teksa shkruaj këta rreshta për romancierin e parë për fëmijë në Kosovë, shkrimtarin e talentuar Rexhep Hoxha, vetiu më lindi pyetja: "A kishte vertikalisht, në vite e dekada, letërsia shqipe për fëmijë e të rinj?" Një të tillë lartësi ia ka dhënë edhe prozatori Hoxha që me ardhjen e tij të parë në fushën e botimeve. Romani i tij "Lugjet e Verdha" ishte një befasi për kohën. Romani në fjalë e kaloi dhe kohën e tij dhe sot po mbetet një vepër e frymëzuar dhe e shkruar nga një dorë mjeshtri. "Lugjet e Verdha" zgjoi dhe interesin e studiuesve dhe të kritikëve. Në këtë rrugëtim shkrimtarin Hoxha e shoqëroi, e pse jo, edhe një "kalvar". Ndërsa në aspektin letrar po ta analizosh imtësisht veprën në fjalë shumë dukuri kanë mbetur pa u trajtuar. Nga ajo shumësi mendimesh, analizat e recensuesit Ramadan Musliujanë mjaft të arrira. Përse e them? Vështrimet për veprat e këtij krijuesi kanë qenë më shumë horizontale, ndërsa vetë ai ishte në një pikë tjetër lartësore të vertikalishtit të tij dhe të dimensionit letrar. Psh., edhe sot më bën përshtypje, pse "u harrua" së analizuar mistika e veprave të tij (?). Një fenomen i tillë, lidhur me mistikën, ka ndodhur edhe me veprën "Shpella e piratëve" të Petro Markos.

Krijimtaria e shkrimtarit nga Kosova Rexhep Hoxha, me mesazhet e tij brenda veprave që na dhuroi në shumë gjini e zhanre, kohës i ka dhënë lavdinë e tij. Patjetër që koha, nuk do të vonojë, koha nuk do të heshtë e do t'ia kthejë lavdinë e merituar...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli synon ta ruajë pozitën e parë

Kampionët e Feronikelit janë përgatitur maksimalisht që ta fitojnë edhe ndeshjen në përballjen me Ferizajn e cila zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 15:00. "Ne jemi duke e pritur një ndeshje shumë të vështirë. Sezonin e kaluar kemi humbur ndeshjen kundër tyre në shtëpi dhe gati e kemi humbur titullin e kampionit. Kemi punuar që t'i evitojmë gabimet dhe të bëjmë paraqitje të mirë. Nuk duhet t'i bëjmë gabimet e njëjta si në ndeshjen e fundit", ka thënë Agostinho Da Silva



duhet t'i bëjmë gabimet e njëjta si në ndeshjen e fundit", ka thënë Agostinho Da Silva.

Ndryshe nga skuadra e Feronikelit, Ferizaj nuk po kalon nëpër momente të mira, pasi nga gjashtë ndeshjet e zhvilluara i ka humbur katër, kurse dy prej tyre ka arritur t'i fitojë. Për ndeshjen ndaj kampionëve ka folur edhe mbrojtësi i Ferizajt, Dardan Çerkini. Ky i fundit nuk ka parashikuar ndonjë epilog të ndeshjes, por ka premtuar se do të angazhohet maksimalisht në këtë përballje. "Sa i përket ndesh-

jes së ardhshme ndaj Feronikelit, mund të them se është e vështirë, sepse kundërshtari është kampion në fuqi dhe fitues i Kupës. Ne do të shkojmë në Drenas që ta japim maksimumin dhe të shohim çfarë rezultati mund të nxjerrim. E mira është se nuk kemi asnjë mungesë për këtë ndeshje kaq të rëndësishme", ka thënë Çerkini.

Sot zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera ku takohen Llapi - Dukagjini dhe Trepça '89 - Flamurtari. Ndërsa të dielën zhvillohet derbi më i madh në futbollin e Kosovës

IPKO SUPERLIGA

Të shtunën takohen:

13:00 Feronikeli - Ferizaj
14:00 Llapi - Dukagjini
15:00 Trepça '89 - Flamurtari

Të dielën takohen:

15:00 Gjilani - Drita
15:00 Vushtrria - Prishtina
14:00 Drenica - Ballkani

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:

Arbëria - KEK-u
Istogu - Besa
Liria - Vitia

Të dielën takohen:

Trepça - 2 Korriku
Onix - Drenasi
Ulpijana - Ramiz Sadiku
Vëllaznimi - Malisheva
Dardana - Vllaznia

në mes të Gjilanit dhe Dritës, kurse në kuadër të kësaj xhiro takohen edhe Vushtrria - Prishtina dhe Drenica - Ballkani.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Kampioni në fuqi i IPKO Superligës, Feronikeli, sot (e shtunë) e pret skuadrën e Ferizajt në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në kuadër të javës së shtatë. "Nikli" që mori kreun e tabelës, pas humbjes së Gjilanit nga Prishtina, po synon ta fitojë edhe përballjen me Ferizajn në mënyrë që të mbetet në këtë pozitë edhe pas ndeshjeve të kësaj fundjave. "Nikli" ka pikë të barabarta me Gjilanin, por ky i fundit në këtë xhiro tako-

het me rivalët e Dritës që pozicionohen në pozitën e tretë me vetëm një pikë më pak të grumbulluar.

Futbollisti Jean Agostinho da Silva - Carioca ka thënë për "BlicMedia" se skuadra nga Drenasi nuk bën ta bëjë gabimin e njëjtë sikurse në vitin e kaluar ndaj Ferizajt. "Ne jemi duke e pritur një ndeshje shumë të vështirë. Sezonin e kaluar kemi humbur ndeshjen kundër tyre në shtëpi dhe gati e kemi humbur titullin e kampionit. Kemi punuar që t'i evitojmë gabimet dhe të bëjmë paraqitje të mirë. Nuk

Hajdari: Feronikeli synon të jetë shembull në Superligë



PRISHTINË, 27 SHTATOR - Skuadra e inkuadruar këtë sezon në Superligë, Feronikeli, synon të jetë shembull në elitën e basketbollit të Kosovës. Skuadra nga Drenasi ka si qëllim kryesor të zhvillojë ndeshje të bukura dhe tifozët e tij të jenë të kënaqur, por edhe që ta sigurojë qëndrimin në elitë edhe për një vit tjetër. Drenicasit kanë bërë disa përforsime në mënyrë që të kenë paraqitje sa më të mira. Një nga

lojtarët më të dalluar vendor është Arti Hajdari. Ai flet për përgatitjet dhe synimet në edicionin e ri. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë deri më tani. Të gjithë lojtarët po japin maksimumin dhe presim vetëm fillimin e kampionatit, që nis në këtë fundjavë. Ndeshjen e parë do ta kemi ndaj Golden Eagle Ylli, që është debutim për ne në garat e elitës. Synimet e Feronikelit janë që të tregojmë lojërë sa më të mira dhe

të jemi shembull për një skuadër që debuton në Superligë dhe të jemi befasia e këtij kampionati", ka thënë Hajdari për faqen zyrtare të FBK-së.

Takimi ndaj Yllit është debutim edhe historik për skuadrën nga Drenasi në Superligë, që brenda një kohe shumë të shkurtër ka arritur që të jetë pjesë e elitës. Ylli - Feronikeli zhvillohet sonte (e shtunë) në palestrën "13 Qershori" nga ora 19:00.

SHKURT

Khaka, kapiten i përhershëm i Arsenalit

Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, ka emëruar mesfushorin shqiptar Granit Xhaka si kapiten i përhershëm i këtij klubi. Emery ka informuar skuadrën e tij për këtë vendim në mëngjesin e sotëm përpara udhëtimit të ekipit të Arsenalit drejt "Old Trafford", ku do të përballen me Manchester Unitedin të hënën. Xhaka ka udhëhequr skuadrën në gjashtë nga tetë ndeshjet e tyre të para të këtij sezoni, por Emery nuk kishte marrë vendimin përfundimtar nëse ai do të ishte kapiteni apo ajo. Emery është konsultuar me lojtarët e ekipit para se të vendosë që Xhaka të caktohet kapiten i përhershëm. Emery ende nuk ka caktuar zëvendëskapitenin e ekipit, ndërsa

Alexander Lacazette dhe Pierre-Emerick Aubameyang shihen si pretendentë kryesorë.

Edmond Thaçi, kryetar i ri i ShGSK-së

Gazetari i Radio Kosovës, Edmond Thaçi, është zgjedhur kryetar i ri i Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës. Në kuvendin e kësaj shoqate, i cili u mbajt sot në Shtëpinë e Sporteve në Prishtinë, Thaçi është votuar unanimisht nga të gjithë pjesëmarrësit e këtij kuvendi, duke e pasuar në këtë pozitë Arlind Grantollin, i cili e drejtoi me sukses këtë shoqatë në mandatin katërvjeçar, gjatë së cilës periudhë ShGSK arriti të anëtarësohet në AIPSA. Ndërkohë, në votimin e fshehtë për anëtarë të ri të Bordit të ShGSK-së u zgjodhën Alba Merovci (RTK), Jon Ajeti (Klan Kosova), Qendresa Krelani (Radio Kosova), Lorik

Jashanica (Gazeta Blic) dhe Arbnor Rahova (RTV Dukagjini), derisa në pozitën e sekretarit u zgjodh Artan Muhaxheri (RTK).

Western Unitedi e rikthehen Berishën në Australi

Sulmuesi nga Kosova, Besart Berisha, është rikthyer në kampionatin australian. Pas aventurës njëvjeçare në Japoni te skuadra Sanfrece Hiroshima, Berisha tani është rikthyer në shtetin australian. Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë dhe Përfaqësueses së Kosovës, Besart Berisha, ka nisur aventurën e tij të re në Australi, duke firmosur me klubin e Western Unitedit. 34-vjeçari është prezantuar me skuadrën e tij të re dhe është gati të vazhdojë sërish në Australi. Berisha që prej vitit 2011 luan

në Australinë e largët dhe ka luajtur më parë për Brisbane Roar dhe Melbourne Victory.

Drejtuesit e FFK-së dhe zyrtari i UEFA-s vizituan Trepçën '89

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu, në shoqëri të përzgjedhësit Bernard Challandes dhe shefit të edukimit të gjeneratave të reja në UEFA, Jean Francois Domergue, kanë qëndruar në Mitrovicë, ku e kanë vizituar fushën me bari sintetik të ndërtuar kohë më parë në kuadër të partneritetit të FFK-së me UEFA-n. Ata janë pritur nga drejtuesit e sportit në këtë qytet dhe nga drejtuesit e klubit Trepça '89. Kësisoj, zyrtari i UEFA-s ka pasur rastin të ndjekë një stërvitje të grupmoshave të reja të Trepçës '89.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transportation

SHPALLJA E REKRUTIMIT
Oglas za regrutiranje

Institucioni: Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit Vazhdon afatin e konkursit per kete vende pune:
Institucija: Ministarstvo Infrastrukture i Transporta Produzava rok konkursa za sledece radno mesto:

Institucioni/Institucija MIT/MIT **kërkon të punësojë** (titullin e pozitës)

në (departamentin/drejtoretin/divizionin,njësinë) e /zeli da regrutuje (naziv posla u odeljenju/direkciji,diviziji ili sektoru) **Divizioni i Auditimit të Brendshëm / Divizija za unutrašnju reviziju:**

Titulli i vendit të punës /Naziv radnog mesta: **Auditor/c i/c Brendshëm/mc / Unutrašnji/ca Revizor**

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës? Niveli profesional 3 grada 8 (BKK 15), Funkcionalna kategorija i stepen radnog mesta/ Nivo upravljanja 3-stepen 8 (BKK 15),

Numri i referencës së vendit të punës/Broj radnog mesta/ RN00005764

(Shënoni saktësisht por me pak fjale detyrat dhe përgjegjësitë kryesore)/(Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti):

- Të kryej auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statutin e auditimit të brendshëm, kodin e etikës së Auditorit si dhe standardet dhe Praktikant profesional të miratuar nga Ministria e Financave.
- Të marrë, shqyrtojë dhe shfrytëzojë pa kufizim të gjitha të dhënat teknike, ekonomike, financiare si dhe informatat e dokumentet në posedim ose kontroll të subjektit të sektorit publik nën auditim;
- Të kopjojë të dhënat, informatat apo dokumentet e tilla për qëllime të auditimit të si dhe të sigurojë që kopjet në fjalë të jenë ose origjinale ose të certifikuara. Dokumentet origjinale duhet të kthehen subjektit të sektorit publik nga i cili janë marrë për shfrytëzim;
- Të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar ose kontraktues i subjektit të sektorit publik nën auditim që të ofrojë dëshmi fizike, shënime dhe dëshmi gojore ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë nën auditim;
- Të ketë qasje pa pengesë në pasurinë e subjektit të sektorit publik nën auditim, dhe të verifikojë dhe vlerësojë vlerat materiale dhe monetare të subjektit të sektorit publik në pajtim me rregullat dhe legjislacionin;
- Të raportojë menaxhmentit të lartë të SSP mbi të gjitha çështjet materiale të lidhura me kryerjen e auditimit të brendshëm dhe me rezultatet e tij.
